

# Dituri natyre 3

## Planifikimi vjetor dhe modele ditaresh

BOTIME



**PLANIFIKIMI VJETOR**  
**FUSHA: SHKENCAT NATYRORE**  
**LËNDA: DITURI NATYRE**

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT PËR KLASËN E TRETË

| Tematikat     | Përmbajtja sipas tematikave  | Orët mësimore për tematikë |
|---------------|--|----------------------------|
| SISTEMET      | <b>Bimët</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesët e një bime me lule</li> <li>• Kërkesat e një bime për të jetuar</li> <li>• Transporti i ujit të bima</li> </ul> | <b>10</b>                  |
|               | <b>Njerëzit dhe kafshët</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ushqyerit</li> <li>• Mbështetja dhe lëvizja</li> </ul>   | <b>10</b>                  |
| DIVERSITETI   | <b>Materialet</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikimi i materialeve</li> <li>• Vetitë magnetike të materialeve.</li> <li>• Ndarja e materialeve</li> </ul>  | <b>7</b>                   |
| NDËRVEPRIMET  | <b>Forcat</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Forcat e shtytjes dhe tërheqjes</li> <li>• Forca dhe lëvizja</li> <li>• Fërkimi</li> </ul>                            | <b>8</b>                   |
| <b>Totali</b> |  | <b>35</b>                  |

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

### Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Nxënësi/ja:

1. paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup;
2. përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe e prezanton atë para të tjerëve.

### Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

1. gjen veçoritë e një objekti, dukurie apo ngjarje të dhënë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;

2. krahason objektet, materialet e paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë etj., dhe tregon funksionin që kanë në natyrë apo në shoqëri;
3. gjen dhe ndan në grupe të përbashkëta dallimet ndërmjet gjallesave, ngjarjeve, dukurive të njohura si dhe shkruan për to, të paktën gjysmë faqe fletore (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në një rën nga format shprehëse;
4. ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna;
5. arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi në kohëzgjatje nga 3-5 minuta.

### **Kompetenca e të nxënësve**

Nxënësi/ja:

1. përzgjedh materialet/mjetet si: letrën, plastelinën, shkopinjat, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
2. ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material për të realizuar një veprimtari / aktivitet/detyrë që kërkohet;
3. parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në një rën nga format e të shprehurit;
4. zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
5. mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve-vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen;
6. grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;
7. identifikon njohuritë që ka, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo veprimtari të caktuar dhe kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi/ja:

1. përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, vizatim, shenja apo simbole, për dy-tri aktivitete ditore, duke patur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;
2. kontrollon mjetet /materialet dhe kohën, që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë, shkollë apo jashtë saj);
3. diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon, gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar;
4. gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës prej formave të të shprehurit duke i diskutuar në grup;
5. identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/veprimtarie në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak, në lagje/komunitet;

6. diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë veprimi për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

### **Kompetenca personale**

Nxënësi/ja:

1. prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron;
2. bën një listë me ushqimet që konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet si dhe ndërmerr masa parandaluese për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga papastërtitë dhe përdorimi i tepruar i tyre (duke përdorur një nga format shprehëse si: shkrim, vizatim etj.);
3. tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe menaxhimit të kohës së lirë në të mirën e shëndetit dhe mirëqenies së vet, duke ndarë përvojat me të tjerët;
4. përkujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë realizimit të një aktiviteti, duke krijuar kushte të përshtatshme pune (ajrosje, ndriçim, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

### **Kompetenca qytetare**

Nxënësi/ja:

1. prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi, në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), tregon detyrat dhe i diskuton me bashkëmoshtarët;
2. diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat në grup, në klasë, për realizimin e aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.;
3. arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë dhe shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulli në shembullin e caktuar;
4. shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
5. identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme, nga të cilët kërkohet ndihma në situatat e rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor.

### **Kompetenca digjitale**

Nxënësi/ja:

1. njeh disa mjete të thjeshta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
2. tregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuësi), me përmbajtje jo më shumë se një faqe teksti;
3. realizon punime origjinale, vetjake, duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre;
4. kupton rëndësinë e ruajtjes së të dhënave individuale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë, moshë) dhe mospublikimit të tyre në asnjë burim informacioni të palicencuar.

## **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

### **TEMATIKA: SISTEMET**

#### **Përshkrimi i tematikës:**

Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku, për të kryer një funksion të caktuar.

Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut.

Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon

secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo temë përqendrohet te studimi i sistemit të bimëve dhe kafshëve, sistemit elektrik, sistemeve të matjes.

#### **Rezultatet e të nxënit**

##### **Bimët**

##### ***Shkathësitë dhe procedurat***

Nxënësi/ja:

- dallon se bimët kanë rrënjë, kërcell, gjethë dhe lule;
- shpjegon nga vëzhgimet se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten;
- përshkruan:
  - se uji thithet nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit.
  - se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcel dhe gjethë që të rriten mirë.
- planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar për çfarë kanë nevojë bimët;
- eksploron rolin e lules në ciklin jetësor të një bime.

##### ***Qëndrimet dhe vlerat***

Nxënësi/ja:

- tregon kuriozitet gjatë zhvillimit të eksperimenteve me bimët;
- skicon dhe kryen një eksperiment “të ndershëm” për të vlerësuar ndikimin e faktorëve fizikë në jetën e bimëve.
- vlerëson përpjekjet e secilit dhe të grupit gjatë zhvillimit të veprimtarive.

##### **Njerëzit dhe kafshët**

##### ***Shkathësitë dhe procedurat***

Nxënësi/ja:

- tregon se kafshët, përfshirë njeriun, kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë;
- krahason dieta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë;
- dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje;
- ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.;
- kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një dietë e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm;

- tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.

### ***Qëndrimet dhe vlerat***

Nxënësi/ja:

- diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë;
- tregon interes:
  - kur kërkon informacion dhe bën pyetje për ushqimet, që dëmtojnë shëndetin e njeriut.

## **TEMATIKA: DIVERSITETI**

### **Përshkrimi i tematikës:**

Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën në të cilën jeton, njeriu përpiqet të organizojë botën e gjallë dhe jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qeniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës.

Në fokus të kësaj tematike në këto shkallë është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjedisit natyror, lëndëve dhe vetive e karakteristikave të tyre.

### **Rezultatet e të nxënit**

#### ***Shkathësitë dhe proceset***

Nxënësi/ja:

- vëzhgon dhe përshkruan lëndët në bazë të vetive të tyre si: fortësia, butësia, ashpërsia, shkëlqimi metalik;
- klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre;
- eksploron dhe përshkruan mënyrën se si disa materiale magnetizohen dhe disa jo;
- eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.

### ***Qëndrimet dhe vlerat***

Nxënësi/ja:

- tregon objektivitete, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve;
- tregon kuriozitet për:
  - a) ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre;
  - b) përdorimin e magnetëve;

## **TEMATIKA: NDËRVEPRIMET**

### **Përshkrimi i tematikës:**

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit e njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën si njeriu

ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.

Tematika fokusohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut, mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, sistemit diellor dhe Tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.

### Rezultatet e të nxënit

#### *Shkathësitë dhe proceset.*

Nxënësi/ja:

- përshkruan:
  - a) shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave;
  - b) si forcat ndryshojnë formën e trupave;
  - c) si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre;
  - d) si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin;
- mat forcën me dinamometër;
- demonstroi lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes;
- hulumton:
  - a) ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të;
- regjistron:
  - a) mënyrën e lëvizjes së trupave;
  - b) forcat që veprojnë mbi trupat;
- krahason:
  - a) mënyrën e lëvizjes së trupave;
  - b) forcat që veprojnë mbi trupa.

### Qëndrimet dhe vlerat

Nxënësi/ja:

- tregon kuriozitet:
  - a) për mënyrën e lëvizjes së trupave;
  - b) për shkaqet e ndryshimit të lëvizjes së trupave kur mbi ta veprojnë forca;
- vlerëson me objektivitet rezultatet e provave të tij krahasuar me ato të shokëve.

### **SHPËRNDARJA E PËRMBAJTIES SË LËNDËS**

| <b>Tematika/Shkalla 1</b> | <b>Sistemet</b> | <b>Diversiteti</b> | <b>Ndërveprimet</b> | <b>Gjithsej:</b> |
|---------------------------|-----------------|--------------------|---------------------|------------------|
| Klasa e tretë             | <b>20</b>       | 7                  | <b>8</b>            | 35 orë           |

## Shpërndarja vjetore e përmbajtjes së lëndës

| Tematika            | Tremujori 1<br>11 orë<br>Temat mësimore   | Tremujori 2<br>12 orë<br>Temat mësimore  | Tremujori 3<br>12 orë<br>Temat mësimore   |
|---------------------|---|--|---|
| <b>Sistemet</b>     | <p><b>Kujdesi për bimët</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bima dhe pjesët e saj.</li> <li>2. Bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë.</li> <li>3. Transportimi i ujit në bimë.</li> <li>4. Ndikimi i temperaturës në rritjen e bimës.</li> <li>5. Kontrolloni përparimin tuaj.</li> </ol> <p><b>Kujdesi për veten</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>6. Grupet e ushqimeve.</li> <li>7. Dieta e shëndetshme</li> <li>8. Dieta e pashëndetshme.</li> <li>9. Ushtrimet fizike dhe gjumi</li> <li>10. Kontrolloni përparimin tuaj.</li> <li>11. Detyrë përmbledhëse. (Test)</li> </ol> | <p><b>Gjallesat</b></p> <p>Gjallesat dhe jogjallesat.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja dhe ushqyerja e gjallesave.</li> <li>2. Riprodhimi dhe lëvizja e gjallesave.</li> <li>3. Skeleti.</li> <li>4. Muskujt.</li> <li>5. Të ngjashëm dhe të ndryshëm.</li> <li>6. Grupimi i gjallesave.</li> <li>7. Kontrolloni përparimin tuaj.</li> <li>8. Detyrë përmbledhëse. (Test)</li> </ol> |   |
| <b>Diversiteti</b>  |   | <p><b>Materialet</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>9. Vetitë e materialeve.</li> <li>10. Grupimi i materialeve sipas vetive të tyre.</li> <li>11. Përdorimet e materialeve.</li> </ol>  | <p><b>Materialet</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Provojmë materiale të ndryshme.</li> <li>2. Materialet magnetike.</li> <li>3. Kontrolloni përparimin tuaj.</li> <li>4. Projekt: Ndërtojmë një lodër.</li> </ol>  |
| <b>Ndërveprimet</b> |   |  | <p><b>Forcat dhe lëvizja</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Shtytja dhe tërheqja.</li> <li>6. Ndryshimi i formës së materialeve.</li> <li>7. Madhësia e forcës.</li> <li>8. Forcëmatësi.</li> <li>9. Fërkimi.</li> <li>10. Kontrolloni përparimin tuaj.</li> <li>11. Detyrë përmbledhëse. (Test)</li> <li>12. Projekt: Ndërtojmë një lodër.</li> </ol> |



**PLANIFIKIMI**  
**3- MUJORI I PARË**  
**FUSHA: SHKENCAT NATYRORE**  
**LËNDA: DITURI NATYRE**

| Nr | Tematikat   | Tema mësimore                          | Situata e parashikuar e të nxënërit            | Metodologjia  | Vlerësimi   | Burimet e materialet didaktike  | Data | Dita |
|----|---|--|--|---|---|---|------|------|
| 1. | <b>Sistemet Kujdesi për bimët</b>                                       | Bima dhe pjesët e saj.                 | Studiojmë pjesët e bimës                       | Përmbledhja pohim mbështetje:   | Tregon se bimët përbëhen nga rrënjët, kërcelli, gjethet dhe lulët.                                  | Programi lëndor. Teksti shkollor fletorja e punës,                              |      |      |
| 2. |   | Bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë.   | Ndikimi i ujit dhe dritës në rritjen e bimëve. | Diskutim Projekt:   | Shpjegon nga vëzhgimet se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten.                         | bimë te ndryshme që gjenden në mjedisin përreth                                 |      |      |
| 3. |   | Transportimi i ujit në bimë.           | T <sup>o</sup> i ndërrojmë ngjyrë bimëve.      | Diskutim për njohuritë paraprake Eksperiment                                      | Kryen një eksperiment “të ndershëm” për të vlerësuar ndikimin e faktorëve fizikë në jetën e bimëve. | vazo me bimë një degë selino, një enë me ujë, ngjyrues bimë, termometër, vizore |      |      |
| 4. | Ndikimi i temperaturës në rritjen e bimës. Kontrolloni përpatimin tuaj. | Në ç temperaturë rriten më mirë bimët? | Hetim  | Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar rreth çfarë kanë nevojë bimët.         |   |   |      |      |
| 5. |   | Unë di...                              | Projekt:                                       | Argumenton se bimët kanë nevojë për rritje, kërcel dhe gjethet që të rriten mirë. | enciklopedi   |   |      |      |

| Nr  | Tematikat                         | Tema mësimore                | Situata e parashikuar e të nxënërit | Metodologjia                               | Vlerësimi   | Burimet e materialet didaktike             | Data | Dita |
|-----|-----------------------------------|------------------------------|-------------------------------------|--|---|--|------|------|
| 6.  | <b>Sistemet Kujdesi për veten</b> | Grupet e ushqimeve.          | Emërtimet e ushqimeve               | Kërkim-hulumtim                            | Iregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.                   | ushqim i vërtetë paketim ushqimi           |      |      |
| 7.  |                                   | Dieta e shëndetshme.         | Shijojmë fruta e perime             | Diskutim për njohuritë paraprake Hulumtim: | Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë. | fruta dhe perime të ndryshme               |      |      |
| 8.  |                                   | Dieta e pashëndetshme.       | E shëndetshme apo e pashëndetshme.  | Ditar dypjesësh Hetim                      | Iregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.          | pije me shumë sheqer, ujë, lëvozhga vezësh |      |      |
| 9.  |                                   | Ushtrimet fizike dhe gjumi.  | Ç' ndodh me trupin tonë?            | Lojë diskutim                              | Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë  | kronometër hapësirë e madhe                |      |      |
| 10. |                                   | Kontrolloni përparimin tuaj. | Unë di...                           | Ekspozim i punimeve:                       | Iregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.          | enciklopedi                                |      |      |
| 11. |                                   | Detyrë përmbledhëse. (Test)  | Unë di...                           | Punë e pavarur Test                        | Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë  | flota e detyrës përmbledhëse               |      |      |

**PLANIFIKIMI 3- MUJORI I DYTË  
FUSHA: SHKENCAT NATYRORE  
LËNDA: DITURI NATYRE**

| Nr  | Tematikat                 | Tema mësimore                        | Situata e parashikuar e të nxënit                    | Metodologjia  | Vlerësimi   | Burimet e materialet didaktike                     | Data | Dita |
|-----|---------------------------|--------------------------------------|--|---|---|--|------|------|
| 12. |                           | Gjallesat dhe jogjallesat.           | Është gjallesë apo jogjallesë?                       | Diskutim për njohuritë paraprake (Organizuesi grafik) | Përshkruan ndryshimet midis gjallesave dhe jogjallesave, duke përdorur njohuritë mbi proceset jetësore.             | Programi lëndor. Teksti shkollor fletorja e punës, |      |      |
| 13. |                           | Rritja dhe ushqyerja e gjallesave.   | Ushqejmë zogjtë                                      | Veprimtari praktike                                   | Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.      | enë plastike, spango, fara për zogjtë              |      |      |
| 14. |                           | Riprodhimi dhe lëvizja e gjallesave. | Ndërtojmë një model me pjesët e lëvizshme të trupit. | Veprimtari: Diskutim                                  | Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.                | një model me pjesët e trupit                       |      |      |
| 15. | <b>Sistemet Gjallesat</b> | Skeleti                              | Ku ndodhen kokcat në trupin tonë?                    | Hetim   | Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.         | model mësimor skeleti njeriu ose kafshe            |      |      |
| 16. |                           | Muskujt                              | Provojmë muskujt                                     | Shpjegim i përparuar: Hetim                           | Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.                | enciklopedi  |      |      |
| 17. |                           | Të ngjashëm dhe të ndryshëm.         | Më shumë ngjajmë apo ndryshojmë?                     | Hetim Mbledhja e të dhënave                           | Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.         | letër, tabelë, laps                                |      |      |
| 18. |                           | Grupimi i gjallesave.                | Grupojmë gjethet                                     | Lojë Diskutim   |   | gjethe të ndryshme                                 |      |      |
| 19. |                           | Kontrolloni përparimin tuaj.         | Unë di...  | Ekspozim i punimeve                                   | Krahason dieta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtrëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë. | enciklopedi tabak letre, lapsa, ngjyra             |      |      |
| 20  |                           | Detyrë përmbledhëse. (Test)          | Unë di...  | Punë e pavarur Test                                   |   | fleta e detyrës përmbledhëse                       |      |      |

| Nr  | Tematikat                      | Tema mësimore                               | Situata e parashikuar e të nxënësit       | Metodologjia                    | Vlerësimi   | Burimet e materialet didaktike                         | Data | Dita |
|-----|--------------------------------|---|---|---------------------------------|---|--|------|------|
| 21. | <b>Diversiteti Materiallet</b> | Vetitë e materialeve.                       | Çfarë materiali është?                    | Vrojtim<br>Bisedë               | Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve. | materiale të ndryshme                                  |      |      |
| 22. |                                | Grupimi i materialeve sipas vetive të tyre. | Të klasifikojmë materialet.               | Kërkim<br>Imagjinatë e drejtuar | Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.  | objekte të ndryshme që përbëhen vetëm nga një material |      |      |
| 23. |                                | Përdorimet e materialeve.                   | Gjetje inteligjente dhe gjetje pa kuprim. | Veprimtari<br>Lojë              | Vëzhgon dhe përshkruan lëndët në bazë të vetive të tyre si: fortësia, butësia, ashpërsia, shkëlqimi metalik.                                      |  |      |      |

**PLANIFIKIMI 3- MUJORI I TRETË  
FUSHA: SHKENCAT NATYRORE  
LËNDA: DITURI NATYRE**

| Nr  | Tematikat                              | Tema mësimore                      | Situata e parashikuar e të nxëniet | Metodologjia   | Vlerësimi   | Burimet e materialet didaktike  | Data | Dita |
|-----|--|------------------------------------|------------------------------------|--|---|---|------|------|
| 24. |  | Provojmë materiale të ndryshme.    | Cili material është më i mirë?     | Hetimi<br><i>Përfundime</i>                              | Diskuton pse disa lëndë përdoren për qëllime të caktuara, duke u bazuar te vetitë e tyre.   | Programi lëndor.<br>Teksti shkollor Fletorja e punës,<br>objekte të ndryshme që përbëhen nga një material |      |      |
| 25. | <b>Diversiteti Materialiet</b>         | Materialiet magnetike              | Cilat materiale janë magnetike?    | <i>Diskutim për njohuri të paraprake</i><br><i>Hetim</i> | Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.   | magnet  |      |      |
| 26. |  | Kontrolloni përparimin tuaj.       | Unë di...                          | Ekspozim i punimeve                                      | Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve. | tabak letre, lapsa, ngjyra  |      |      |
| 27. |  | Projekt: Ndërtojmë një lodër       | Lodra jonë                         | “Panairi i lodrave”.                                     | Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.  | materiale të ndryshme   |      |      |
| 28. |  | Shtyja dhe tërheqja.               | Si ndikojnë forcat tek objektet?   | <i>Veprimtari</i><br><i>Diskutim</i>                     | Përkrauan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.   | <i>Objekte të ndryshme</i>  |      |      |
| 29. | <b>Ndërveprimet Forcat dhe lëvizja</b> | Ndryshimi i formës së materialeve. | Ndryshimi i formës.                | Veprimtari<br>Hetim                                      | Përkrauan si forcat ndryshojnë format e trupave.  | <i>Plastelinë</i>   |      |      |
| 30. |  | Madhësia e forcës.                 | Sa e madhe është forca që ushtrro? | Hetim<br>Përfundime                                      | Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.   | tullumbase, objekte të ndryshme   |      |      |

| Nr  | Tematikat | Tema mësimore   | Situata e parashikuar e të nxënësit | Metodologjia           | Vlerësimi   | Burimet e materialet didaktike    | Data | Dita |
|-----|-----------|---|-------------------------------------|------------------------|---|-----------------------------------|------|------|
| 31. |           | Forcëmatësi.  | Matja e forcave                     | Provë<br>Diskutim      | Mat forcën me dinamometër.  | forcëmatës                        |      |      |
| 32. |           | Fërkimi.  | Forca dhe fërkimi                   | Prova<br>Diskutim      | Përkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes. | forcëmatës, sipërfaqe të ndryshme |      |      |
| 33. |           | Kontrolloni përparimin tuaj.                                      | Unë di...                           | Lojë                   | Përkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.  | tabak letre, lapsa, ngjyra        |      |      |
| 34. |           | Detyrë përmbledhëse.<br>(Test)<br>Projekt:<br>Ndërtojmë një lodër | Unë di...                           | Punë e pavarur<br>Test | Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.  | fleta e detyrës përmbledhëse      |      |      |
| 35. |           |   | Lodra jonë                          | “Panairi i lodrave”.   | Përdor materiale për qëllime të ndryshme.   | materiale të ndryshme             |      |      |

## KAPITULLI 1: KUJDESI PËR BIMËT

### Ora 1

|  |                             |   |             |
|--|-----------------------------|---|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 2</b>  | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Bima dhe pjesët e saj  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Studiojmë pjesët e bimës  |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/>                 Dallon se bimët kanë rrënjë, kërcell, gjethe dhe lule.<br/>                 Vlerëson përpjekjet e secilit dhe të grupit gjatë zhvillimit të veprimtarive.</p>  |                             |   |             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/>                     Tregon se bimët përbëhen nga rrënjët, kërcelli, gjethet dhe lulet.</li> <li>Mëson se bimët kanë nevojë për rrënjë, gjethe dhe kërcell të shëndetshëm për t'u rritur siç duhet.</li> <li>Vëzhgon bimët e ndryshme në natyrë.</li> <li>Krahason bimë të ndryshme nëpërmjet krahasimit të pjesëve të tyre.</li> </ul>  |                             | <p><b>Fjalë kyçe:</b> gjethe, lule, rrënjë kërcell, transportoj, i shëndetshëm, i pashëndetshëm</p> |             |
| <p><b>Burimet:</b> mjedisi rreth shkollës, bimë të ndryshme që gjenden në mjedisin përreth<br/> <b>Mjetet:</b> spango, pipëz, ngjitës fletë punëdoreje ose karton me ngjyrë</p>  |                             | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>                 Arte</p>                                   |             |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> U drejtohet pyetja nxënësve:<br/>                 - Çfarë dini për bimët?<br/>                 Ndahen nxënësit në grupe me nga 4 nxënës. I shpërndahet secilit prej grupeve nga një fletë të bardhë ku duke punuar bashkarisht do të vizatojnë figurën e një bime. Më pas me letra ngjitjeje (fleta mbështetëse 1.1) do të shkruajnë pjesët përbërëse të bimës dhe funksionin që ka secila prej tyre.<br/> <i>Përmbledhja pohim mbështetje:</i> Bazuar në përcaktimet që nxënësit sapo thanë ata në grupe kryejnë veprimtari praktike. Kjo veprimtari mund të kryhet dhe jashtë në oborrin e shkollës. Nxënësit vëzhgojnë bimë të përmasave të ndryshme, mundësisht edhe pemë. Ata vizatojnë disa nga bimët e gjetura dhe emërtojnë gjethet, kërcellin e lulet. Gjithashtu ftohen nxënësit të dallojnë bimë jo të shëndetshme. Diskutohet mbi dallimet në shëndetin e bimëve të ndryshme, të mjedisëve ku ato rriten, të përmasave ose shumëllojshmërisë së tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Me ndihmën e Fleta punës 1.1a nxënësit hedhin të dhënat e vëzhgimeve të tyre. Këshillohen nxënësit të kenë kujdes nga bimët përcëlluese dhe bimët me gjëmba. Zhvillohet veprimtaria 1.1 e librit. Nxënësit sipas grupeve krijojnë modele bimësh, duke përdorur letra ose kartona me ngjyra, spango dhe pipëza. Këto modele i prezantojnë dhe i ekspozojnë në tabelën formë vargësh dhe të varen nëpër klasë.</li> </ul> |                             |   |             |

Për nxënësit me arritje të pamjaftueshme, formulohet një listë me fjalët e reja të cilat i lexojnë dhe i përsërisin. Këta nxënës mund t'i rindërtojnë bimën dhe më pas t'i emërtojnë pjesët e saj. *Diskutim* i përfundimeve të vëzhgimeve nëpërmjet të dhënave të hedhura në Fletoren e punës. Pyeten nxënësit nëse gjetën bimë jo të shëndetshme dhe mendimin e tyre në lidhje me të. Fleta e punës 1.1b u shërbën nxënësve të kontrolljnë përvetësimin e njohurive mbi pjesët e bimës.

|   |   |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Vlerësimi:</b> Emërimi i katër pjesët kryesore të një bime.<br/>A janë në gjendje nxënësit të përshkruajnë funksionin e secilës pjesë?</li> <li>● Prezantimi i modeleve të bimëve dhe diskutimi për to.</li> </ul>  |   |
| <p><b>Detyra:</b> Nxënësit zgjedhin sipas dëshirës një rënë prej detyrave:<br/>-Të modelojnë një herbarium me lloje të ndryshme gjetesh e lulësh.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● -Të mbjellin farat e disa bimëve (Si fillim nxënësit duhet të mbjellin disa fasule ose fara luledielli. Ata duhen këshilluar herë pas here që t'i ujisin dhe të kujdesen për to, si dhe të mos e teprojnë me sasinë e ujit. Mund të caktohen disa nxënës që të ngarkohen me këtë detyrë.)</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Refleksion:</b> A jeni të kënaqur me modelet e bimëve që krijuat? Çfarë mund të përmirësojini tek ato?</li> </ul> |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Shënim:</b> Në varësi të kohës dhe mundësive, mësuesi mund t'i organizojë nxënësit që do të ndahen në grupe dhe do të shtrihen në dysheme, ku me anë të trupave të tyre do të formojnë figura bimësh. Njëri do të jetë rrënja, tjetri kërcelli, dhe të tjerët gjethet dhe lulet. Një pjesë tjetër e nxënësve do të luajnë rolin e etiketave ku të emërtohen pjesët e bimës.</li> <li>● Veprimtaria 'Emërto bimët' në faqen <a href="http://www.crickweb.co.uk/ks1science.html">http://www.crickweb.co.uk/ks1science.html</a> do t'ju vijë në ndihmë për përvetësimin e plotë të kësaj teme.</li> <li>● - Në klasë ndërtohet një poster ku të përfshihet fjalori apo gjuha e përdorur që lidhet me bimën. Kjo do t'u mundësojë nxënësve që të plotësojnë në fletën murale për çdo temë të re të kapitullit fjalët e reja. Diskutohet me gjithë klasën rreth kuptimit të tyre.</li> </ul> |   |

## Ora 2

|  |                             |  |             |
|--|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Ndikimi i ujit dhe dritës në rritjen e bimëve. |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Shpjegon nga vëzhgimet se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten.<br/>Përshkruan si uji thithet nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit.<br/>Shpjegon se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcëj dhe gjethe që të rriten mirë.<br/>Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar për çfarë kanë nevojë bimët.<br/>Tregon kuriozitet gjatë zhvillimit të eksperimenteve me bimët.<br/>Kryen një eksperiment "të ndershëm", për të vlerësuar ndikimin e faktorëve fizikë në jetën e bimëve.<br/>Vlerëson përpjekjet e secilit dhe të grupit gjatë zhvillimit të veprimtarive.</p> |                             |  |             |



|  |   |
|--|---|
| <p><b>Rezultatet e të nxënës sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon teorinë se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten.</li> <li>• Kryen matje, duke përdorur pajisje të thjeshta dhe të pasqyron rezultatet në disa mënyra.</li> <li>• Paraqet rezultatet më anë të skicave, diagramave dhe tabelave.</li> <li>• Nxjerr përfundime prej rezultateve dhe përdor njohuritë shkencore, për t'i arsyetuar ato.</li> </ul>  | <p><b>Fjalë kyçe:</b> parashikoj, hulumtim, provë e rregullt, vyshket, shpjegoj</p> |
| <p><b>Burimet:</b> mjedisi i klasës, materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mjete:</b> gjashtë vazo me bimë, ujitëse, një kuti për të mbuluar tri vazo, një kalendar ku tregohen ditët e javës, nëntë vazo me bimë</li> </ul>   | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)</p>                |
| <p><i>Diskutim</i> së bashku me klasën në lidhje me disa terma të rinj të kërkimit shkencor: “parashikimi” dhe “eksperimenti”. U shpjegohet nxënësve se parashikimi është i ngjashëm me hamendësimin, por ai bazohet në njohuritë e përgjithshme që ne kemi. Ndërsa “eksperimenti” kryhet për të kontrolluar faktorët, duke ndryshuar njërin prej tyre kur të tjerët mbeten njësoj. Tërhiqet vëmendja në theksimin se një eksperiment i paanshëm është ai që u jep të gjithëve mundësinë për të bërë matje.</p> <p><i>Projekt:</i> Prezantohet qëllimi i zhvillimit të veprimtarive të nxënësve në lidhje me nevojat e bimës për dritë dhe për ujë.</p> <p>Si fillim, nxënësit organizohen në grupe për të përgatitur një listë të gjërave, për të cilat ata mendojnë se bimët kanë nevojë që të rriten. Duke u orientuar dhe nga figurat e librit në veprimtaritë 1.2a dhe 1.2b përshkruhen eksperimentet që do të zhvillohen së bashku me nxënësit. Në eksperimentin e parë do të vërehet mbi nevojat e bimës për dritë. Në eksperimentin e dytë do të vërehet nevoja e bimëve për ujë.</p> <p>Caktohen grupet e nxënësve dhe rolet e tyre brënda grupit: matja e lartësive të bimëve, marrja e të dhënave dhe hedhjen e tyre në tabelat e fletave të punës 1.2a dhe 1.2b, ujitjen e bimëve, përcaktimin e ditëve në kalendar. Faktorët e tjerë si drita, uji dhe llojet e bimëve të mbeten të pandryshuar. Matjet që do të kryhen do të jenë një herë në tri ditë. Në fletën e punës 1.2c nxënësit do të vizatojnë se ç'ndodh me filizat e mbajtura në kushte të ndryshme. Nëpërmjet përgjigjeve që do të japin, ata do të analizojnë vëzhgimet lidhur me nevojën e bimëve për ujë dhe dritë. Nxënësit me arritje të pakënaqshme mund të praktikojnë përdorimin e vizores para se të fillojnë me matjen e gjatësisë së bimëve. Nxënësit me arritje më të larta mund të planifikojnë hulumtimet e tyre.</p> <p><i>Diskutim:</i> Cilat janë pjesët e bimës? Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten? Në eksperimentet tuaja, cilët janë faktorët që po merren në vëzhgim? Ftohen nxënësit sipas grupeve të tregojnë pritshmëritë e tyre.</p> <p>Diskutohet figura e Hënës e dhënë në libër. Ftohen nxënësit të përshkruajnë pamjen e sipërfaqes së Hënës. A ka bimë ajo? A ka ujë? Të ngrenë pyetje dhe të hamendësojnë për të dhënë përgjigje për to.</p> |   |

Zhvillohet bisedë rreth llojeve të bimëve që rriten në mjedise shumë të thata ose me shumë lagështirë. Prezantimi i disa figura kaktusesh, zambakësh uji ose bimësh të tjera ujore. U shpjegohet nxënësve që këto bimë kanë disa tipare që u mundësojnë atyre t'u përshtaten kushteve të veçanta. Për shembull, kaktuset e depozitojnë ujin në pjesën e kërcellit, ndërsa bimët ujore kanë gjethe lundruese dhe është kërcelli ai që përçon ajrin nga sipërfaqja poshtë te rrënjët.

- **Vlerësimi:** Nëse janë në gjendje të shpjegojnë arsyet pse bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten. Në këtë rast mund të përdoren ngjyrat e dritave të semaforit, ku drita e gjelbër tregon se nxënësi është shumë i sigurt, drita e verdhë paraqet më pak siguri dhe drita e kuqe tregon pasiguri. Do të inkurajohen nxënësit me dritë të verdhë dhe të kuqe, në mënyrë që ata të jenë më të sigurt në shpjegimin e tyre.

**Detyra:**

Zhvillimi i matjeve dhe hedhja e të dhënave të eksperimenteve në vazhdimësi deri në tre jave. Në përfundim, punimi i detyrës së fq. 8 të Fletores së Punës.

**Refleksion:** Të gjithë nxënësit duhet të shkruajnë disa udhëzime mbi përkujdesjen ndaj bimëve. Më pas, secili nga ata do t'i hedhë një sy udhëzimeve të shokut dhe të përmend dy veçori që i pëlqejnë tek ato (të qarta, të renditura mirë) dhe një veçori që ka nevojë për përmirësim (vendosja e numrave).

**Shënim:** Sidoqoftë, rezultatet do të jenë më bindëse nëse përdorni më shumë bimë për secilin nga kushtet e mësipërme. Eksperimenti mund të fillojë të japë rezultatet e para pas një jave, por dallimet do të bëhen më të dukshme pas dy ose tri javësh.

**Ora 3**

| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3   | <b>Data</b> |
|---|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Tema mësimore:</b> Transportimi i ujit në bimë   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> T'i ndërrojmë ngjyrë bimëve. |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>   |                             |  |             |
| Përshkruan si uji thithet nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit.                   |                             |  |             |
| Tregon se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcëj dhe gjethe që të rriten mirë.                        |                             |  |             |
| Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar rreth çfarë kanë nevojë bimët.                           |                             |  |             |
| Tregon kuriozitet gjatë zhvillimit të eksperimenteve me bimët.                                      |                             |  |             |
| Kryen një eksperiment "të ndershëm" për të vlerësuar ndikimin e faktorëve fizikë në jetën e bimëve. |                             |  |             |
| Vlerëson përpjekjet e secilit dhe të grupit gjatë zhvillimit të veprimtarive.                       |                             |  |             |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <p>Zbulon funksionin e rrënjëve dhe kërcellit, duke hulumtuar mënyrën se si selinoja dhe lulet me kërcell përçojnë ujin me ngjyrë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon se uji përthithet nga rrënjët dhe përçohet nëpërmjet kërcellit.</li> <li>• Jep mendime, bën parashikime dhe i paraqet ato në tabela gjatë marrjes së të dhënave nga eksperimenti me bimët.</li> <li>• Vëzhgon dhe krahason faktorët fizikë në jetën e bimës.</li> </ul>  | <p><b>Fjalë kyçe:</b> thith</p>   |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <p><b>Mjetet:</b> një lule e bardhë, një degë selino, një enë me ujë ngjyrues ushqimor blu, thikë plastike</p>   | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte</p>   |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Duke përdorur bimët (fasule ose fara luledielli) të mbjella më parë, ftohën nxënësit të dallojnë e tregojnë pjesët e bimës. Më pas shkulen me kujdes nga ena ku janë vënë për t'u mbjelle përsëri në një enë më të madhe. Demonstrohen rrënjët, pjesa më e madhe e rrënjëve janë të pajisura me disa fije të holla, të cilat shërbejnë për të thithur ujin. Nxënësit i shohin me ndihmën e një lupe zmadhuese dhe diskutohet se si ato thithin ujin për të furnizuar bimën (sikurse ilustruhet në faqen 10 të <i>Librit</i>). Në rast se pjesa më e madhe e rrënjëve është e ngatërruar me njëra-tjetrën në vend që të jetë e ngulur në dhe, atëherë ato nuk mund të thithin sasinë e nevojshme të ujit.</p> <p><i>Eksperiment:</i> përgatitet eksperimenti siç është paraqitur në fq. 11 të librit. U kërkohet nxënësve të parashikojnë atë çka do të ndodhë. Nxënësit plotësojnë me parashikimet Fletën e punës 1.3 dhe i diskutojnë me gjithë klasën, duke dhënë dhe argumentet e tyre rreth: Pse mendojnë se do të ndodhë kështu? Cili është funksioni i pjesëve të bimës?</p> <p>Në dyshe nxënësit diskutojnë dhe përcaktojnë funksionin e pjesëve të bimës. Disa nga dyshet e prezantojnë mendimin e tyre.</p> <p>Sqarohen nxënësit se për të patur rezultate sa më të mira do të presim të kalojë një natë. Ditën e nesërme do të përfundojnë eksperimentin, duke vëzhguar petalet e lules dhe sipërfaqen e prerë të kërcellit të selinosë.</p> <p><i>Diskutim:</i> Çfarë mund të bëhet që lulet e prera ose të këputura të jetojnë pak më gjatë? Çfarë mund të bëjë kërcelli që ta mbajmë lulen sa më gjatë? Ai mund të përçojë ujë nga vazoja te lulja. Nëse lulja nuk ka gjethe që të prodhojë ushqim për të, ajo do të vyshket shpejt, por nëse lulja këputet bashkë me disa gjethe, do të rrojë më gjatë.</p> |   |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit shpjegojnë funksionin e rrënjëve dhe kërcellit të bimës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 9 Fletore Pune</li> <li>• Nxënësit që kanë mbjellë fara në shtëpi mund të kontrollojnë rrënjët dhe nëse është e nevojshme t'i mbjellin përsëri.</li> </ul>  | <p><b>Refleksion:</b> Që të jetojë sa më gjatë një bimë e këputur, duhet këputur vetëm lulja apo edhe një pjesë e kërcellit të saj?</p> |
| <p><b>Shënim:</b> Nëse ka nxënës që mendojnë se rrënjët dhe kërcelli shërbejnë thjesht për të mbajtur bimën, apo besojnë se janë rrënjët ato që thithin ushqim nga toka për t'ia përçarur bimës. Sqarohen se ushqimi prodhohet te gjethet, në prani të ujit dhe dioksidit të karbonit, gjatë procesit të quajtuar fotosintezë.</p>  |   |

Në faqen <http://www.thenakedscientists.com/HTML/content/kitchenscience/exp/colour-your-own-flowers/> paraqiten disa sekuenca filmike ku bimët e bardha ndërrojnë ngjyrë.

## Ora 4

| Fusha: Shkencë  | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3  | Data |
|---|----------------------|--|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Ndikimi i temperaturës në rritjen e bimës.  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Në ç' temperaturë rriten më mirë bimët?  |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/>           Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar rreth çfarë kanë nevojë bimët.<br/>           Tregon kuriozitet gjatë zhvillimit të eksperimenteve me bimët.<br/>           Kryen një eksperiment “të ndershëm”, për të vlerësuar ndikimin e faktorëve fizikë në jetën e bimëve.<br/>           Vlerëson përpjekjet e secilit dhe të grupit gjatë zhvillimit të veprimtarive.</p>  |                      |  |      |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/>Zbulon se si ndikon temperatura në rritjen e bimëve.</li> <li>• Mbledh prova të llojeve të ndryshme për t’u përgjigjur pyetjeve.</li> <li>• Vërteton hipoteza në lidhje me çfarë ndodh me bimën.</li> <li>• Mëson si të mbledh prova dhe të ndërtojë eksperimente, duke përdorur ndihmën e organizuesve grafikë.</li> <li>• Paraqet rezultatet me anë të figurave, grafikëve dhe tabelave.</li> <li>• Bën përgjithësime (ngre hipoteza) dhe gjen të përbashkëtat te rezultatet.</li> </ul>  |                      | <p><b>Fjalë kyçe:</b> termometër, temperaturë, rezultat grafik me shtylla, përfundim</p>                               |      |
| <p><b>Burimet:</b> mjedisi brenda dhe jashtë klasës, enciklopedi<br/> <b>Mjetet:</b> dy vazo me bimë të njëjta, termometër, vizore</p>  |                      | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>           Shkencat sociale (Gjeografi), Matematikë, Gjuhët (Gjuhë Shqipe)</p> |      |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> <i>Harta semantike:</i> Shkruhet në tabelë: Çfarë ndodh me bimën nëse mbahet në kushte shumë të ftohta?<br/>           Çfarë ndodh me bimën nëse mbahet në kushte shumë të ngrohta?<br/>           Prezantohet tema mësimore dhe diskutohet rreth figurave të fq. 12 të librit dhe eksperimentit që do të kryhet. Në të shpjegohet mënyra se si mund të hulumtojmë rritjen e bimëve në temperatura të ndryshme. Gjatë diskutimit punohet kuptimi i fjalëve të tjera kyçe.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Hetim:</i> Ndahen nxënësit në dyshe. Ata do të kenë: dy bimë të ngjashme fasuleje ose luledielli të mbjella në një kavanoz, një termometër. Në varësi të kushteve klimatike/stinës në të cilën ndodheni vendoset së bashku me nxënësit, se cilin prej dy eksperimenteve do të zhvillohet. Që të vërtetohet se bimët nuk rriten të shëndetshme në mjedise shumë të ftohta ose shumë të ngrohta, çdo mjedis i ftohtë që do të zgjidhet, duhet të jetë minimalisht më pak se 10°C. Gjithashtu, çdo mjedis i ngrohtë që do të zgjidhet duhet të jetë aq i ngrohtë, sa të jetë i parehatshëm për bimën. Kështu, nëse temperatura e</li> </ul> |                      |  |      |

|  |  |
|--|--|
| <p>jashtme e ambientit është mbi 20°C, përdorimi i një kutie plastike të tejdukshme në formën e një serre të vogël nën rreze të forta dielli, do ta rriste temperaturën brenda saj në mbi 40°C. Tërhiqet vëmendja e nxënësve se sa më i madh të jetë ndryshimi në temperaturë që do të arrini, aq më të dukshme do të jenë dallimet midis bimëve. Në fletën e punës 1.4a, do të shënohen rezultatet e matjeve.</p> <p>Sqarohen nxënësit se eksperimenti do të japë rezultat pas dy ose tri javësh. Bisedohet me nxënësit se si mund të ndërtohet një eksperiment, duke i ruajtur faktorët e tjerë të pandryshuar, si sasia e ujit, koha nën dritë apo llojet e bimëve. Secila dyshe do të vendosë nga një bimë dhe nga një termometër në secilin prej dy vendeve të përzgjedhura.</p> <p>Nxënësit duhet të jenë në gjendje të vërejnë përmasat, që janë më të vogla se paraardhësja. Zakonisht, bimët që qëndrojnë në kushte shumë të nxehta ose shumë të ftohta kanë prirjen të vyshken dhe të përkulen duke u zvogëluar. Në këtë rast kërkoni prej nxënësve të masin pikën më të lartë të bimës në atë pozicion që ndodhet. Disa nxënës mund të përpiqen ta drejtojnë trupin e bimës para se të bëjnë matjet.</p> <p>Sipas dysheve nxënësit praktikohen në leximin e termometrave që kanë sjellë me vete. Ndërsa nxënësit me arritje të pakënaqshme do të praktikohen dhe duke plotësuar fletën e punës 1.4c.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Diskutim</i> me nxënësit termin ‘bujqësi’. Në çfarë muaji apo muajsh i mbjellin bujqërit farërat? Në çfarë muajsh i mbledhin frytet? Ndërtoni një kalendar vjetor dhe shënoni mbi të kohën e mbjelljes së farërave, rritjes së tyre dhe korrjes së fryteve. Këtu mund t’i riktheheni nevojës që bimët kanë për ujë që të rriten, veçanërisht nëse temperaturat në vendin tuaj nuk ndryshojnë aq sa reshjet e shiut.</li> <li>• Nxiten nxënësit të tregojnë rreth stinëve dhe pse bimët rriten më ngadalë në stinët e ftohta dhe më shpejt në stinët e ngrohta. Sa nga bimët që rriten në vende me klimë të butë, i rrëzojnë gjethet e tyre në vjeshtë, pushojnë së rrituri në dimër dhe çelin gjethë plotësisht të reja në pranverë?</li> <li>• Po në ato vende të botës ku kushtet klimatike nuk janë të përshtatshme për rritjen e bimëve? Studiohen shembujt e dhënë në libër dhe foto të tjera.</li> </ul> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen rreth eksperimentit mbi rritjen e bimëve, nëse janë në gjendje ata të shpjegojnë pse bimët rriten ndryshe në temperatura të ndryshme?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit mund të punojnë në grupe me nga tre, ku çdonjëri të marrë përsipër të luajë nga një rol, njëri të bimës që rritet në kushte të nxehta, njëri të bimës në kushte të ngrohta dhe tjetri të bimës në kushte të ftohta dhe të vënë në jetë, në formë sekuence, mënyrën se si mund të rriten këto bimë.</li> </ul>   |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 10 Fletore Pune</p>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Refleksion:</b> Trego dy nga gjërat që ke mësuar nga ky mësim dhe një gjë tjetër rreth së cilës do të dëshirojë të dije më shumë.</li> </ul> |
| <p><b>Shënim:</b> Nxënësit duhet të punojnë në grupe dhe secili grup duhet të ndërtojë eksperimentin e tij. Megjithatë, nëse numri i mjeteve që keni është i kufizuar, e gjithë klasa mund të vëzhgojë të njëjtat bimë.</p> <p>Eksperimenti mund të thjeshtohet duke lënë mënjanë matjen e temperaturës. Në këtë mënyrë temperatura e secilit prej mjediseve do të kontrollohet përsëri rregullisht, por ajo nuk do të shënohet në tabelën e rezultateve.</p>  |  |

## Ora 5

| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
|--|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...   |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Dallon se bimët kanë rrënjë, kërcell, gjethe dhe lule.<br>Shpjegon nga vëzhgimet se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten.<br>Përshkruan si uji thithët nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit.<br>Argumenton se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcelje dhe gjethe që të rriten mirë.<br>Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar për çfarë kanë nevojë bimët.<br>Eksploron rolin e lules në ciklin jetësor të një bime.<br>Skicon dhe kryen eksperimente, për të vlerësuar ndikimin e faktorëve fizikë në jetën e bimëve.<br>Vlerëson përpjekjet e secilit dhe të grupit gjatë zhvillimit të veprimtarive.  |                      |   |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara.   |                      | <b>Fjalë kyçe:</b> ujë, rrënjë, kërcell, gjethe, lule, transporton, e shëndetshme, të pashëndetshme |      |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjetet:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra   |                      | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte  |      |
| <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br><i>Parashikim me terma paraprakë:</i> Ftohen nxënësit të shohin fjalët e reja të afishuara në faqen e murit. Nëse nuk është plotësuar një fjalor i tillë gjatë orëve të mëparshme, mësuesja shkruan në tabelë fjalët: ujë, rrënjë, kërcell, gjethe, lule, transporton, e shëndetshme, të pashëndetshme, u jepet detyrë nxënësve që duke përdorur të paktën 4 prej këtyre fjalëve të tregojnë çfarë mbajnë mend nga mësimet e mëparshme.<br><i>Projekt:</i> Nxënësit prezantojnë.<br><i>Prezantim i projektit:</i> Të gjitha grupet me të njëjtën kohë në dispozicion prezantojnë përfundimet e projektit, duke argumentuar përfundimet e tyre në lidhje me nevojat e bimës për ujë e dritë dhe duke përdorur fjalorin e duhur.<br>Pas prezantimeve e diskutimeve nxënësit ftohen të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 14 dhe 15 të librit.<br>Në fund u jepet kohë nxënësve që në dyshe të diskutojnë gjetjet me njëri-tjetrin.<br><i>Diskutim;</i> Më pas diskutohen me gjithë klasën përgjigjet e ushtrimit 2, ushtrimit 3 dhe ushtrimit 4. Gjatë diskutimit kërkohet dhe argumentimi i përgjigjeve, duke përdorur fjalorin përkatës.<br>Ftohen nxënësit të shprehin mbresa të tyre në lidhje me grupin e mësimëve të zhvilluara. |                      |   |      |
| <b>Vlerësimi:</b> Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.   |                      |   |      |
| <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 11 Fletore Pune  |                      | <b>Refleksion:</b> Trego me shkrim ose me vizatim një mbresë nga këto grup mësimesh.                |      |
| <b>Shënim:</b> Nxënësit gjatë orës mësimore për argument të mendimeve mund të përdorin dhe shembuj nga enciklopeditë.  |                      |   |      |

## Kapitulli 2: Kujdesi për veten


### Ora 1

|  |                             |  |             |
|--|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Grupet e ushqimeve   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Emërtimet e ushqimeve  |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.</p> <p>Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.</p> <p>Tregon interes kur kërkon informacion dhe bën pyetje për ushqimet që dëmtojnë shëndetin e njeriut.</p>   |                             |  |             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/>Bën kërkime për gjetjen e dietës së shëndetshme.</li> <li>• Studion dietën e duhur dhe të larmishme që nevojitet për të qenë i shëndetshëm.</li> </ul> <p>Vëzhgon dhe krahason sendet, gjallesat dhe dukuritë.</p>   |                             | <p><b>Fjalë kyçe:</b> bulmet, perime, fruta, mish, proteina, energji yndyrë, karbohidrate, peshk</p> |             |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mjetet:</b> ushqim i vërtetë ose model ushqimi, paketim ushqimi ose fotografi ushqimesh, etiketa me emërtimet e grupeve ushqimore.</li> </ul>   |                             | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Shkencat (Biologji), Arte</p>                                |             |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Organizues grafik:</i> Në tabelë shkruhet “Grupet e ushqimeve”. Nxënësit japin mendime rreth çfarë kuptojnë ata me këto fjalë. Më pas klasifikohen në formën e organizuesit grafik (si në figurën e librit) emërtimet e ushqimeve: bulmet, perime, fruta, mish, proteina, energji yndyrë, karbohidrate, peshk.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Me emërtimet e ushqimeve ndërtohet fjalori ushqimor. Ftohen nxënësit të diskutojnë rreth njohurive që kanë mbi lloje të ndryshme ushqimesh dhe ndikimin që ato kanë në organizëm.</li> <li>• <i>Kërkim-hulumtim:</i> Organizohen nxënësit të punojnë në grupe të vogla. Detyra e tyre është të gjejnë grupet ushqimore në të cilat bëjnë pjesë paketat/etiketat ushqimore që ka sjellë çdo pjesëtar i grupit. Nxiten të diskutojnë rreth zgjedhjeve të tyre. Disa ushqime mund të jenë më të vështira për t’u ndarë. Për shembull, gjalpi është nënprodukt i qumështit dhe mund të klasifikohet në grupin e bulmeteve, por ai gjithashtu përmban edhe shumë yndyrna, prandaj mund të bëjë pjesë edhe në grupin e tyre. Gjatë punës nxënësit përdorin fletët plotësuese 2.1 a dhe 2.1 b ku individualisht përcaktojnë grupet ku bëjnë pjesë paketimet e ushqimeve që kanë sjellë, e më pas plotësojnë një tabelë të përbashkët në grup me gjithë zgjedhjet e pjesëtarëve të grupit. Nxënësit me arritje të pakënaqshme</li> </ul> |                             |  |             |

|  |  |
|--|--|
| <p>mund të kenë nevojë për ndihmë në leximin dhe interpretimin e etiketave me përbërësit ushqimorë. Nxënësit me arritje të kënaqshme mund t'i përdorin etiketat me të dhënat e përbërësve ushqimorë që gjenden në ambalazhin e ushqimeve për të krahasuar ushqime të ndryshme, duke u bazuar në sasinë e proteinave ose karbohidrateve në gr/100 g.</p> <p>Në rast se paketimet e ushqimeve kanë etiketa ku përshkruhen përbërësit ushqimorë të artikullit, atëherë orientohen nxënësit të kërkojnë termat e rinj shkencor si karbohidrate, proteina apo yndyrna. Mund të përdoren edhe etiketa në këtë rast nxënësve mund t'u nevojitet ndihmë, për të dalluar emrat e grupeve ushqimore.</p> <p><i>Përfundimet e kërkimit:</i> Përfaqësuesit e grupeve, brenda kohës së caktuar, prezantojnë përfundimet e kërkimeve. Gjatë prezantimit ata duhet të përdorin argumentet dhe fjalorin e duhur për temën.</p> <p>Së bashku me të gjithë nxënësit zhvillohet bisedë rreth dietave të tyre, ushqimeve që pëlqejnë më shumë, ose që nuk u pëlqejnë, apo rreth ushqimeve që konsumojnë më shpesh ose më rrallë. Jepen mendime nga nxënësit për formulimet në figurën e paraqitur në fq. 17 të librit. A janë apo jo ata dakord me këto formulime? A është ndonjëra prej tyre një këshillë e mirë? Pse mendojnë se ky ushqim është i shëndetshëm? Nxënësit ftohen të propozojnë ndonjë tjetër këshillë për Emën.</p> |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Vlerësimi:</b> Nëpërmjet tregimit të shembujve ushqimorë nxënësit të jenë në gjendje të thonë se kujt grupi ushqimor i përkasin ato. Nxënësit mund të testojnë njëri-tjetrin.</li> <li>● Prezantimi i kërkimit dhe përfundimeve të tij. Pjesëmarrja në diskutimi për to.</li> </ul>  |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 12 të Fletores së Punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Nxënësit do të plotësojnë fletën e punës 2.1.</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Refleksion:</b> Nxënësit mund të flasin për mënyrën si ndihen në përfundim të veprimtarisë. A kishte ushqime me të cilat hasën vështirësi për t'i klasifikuar në një grup të vetëm? Cila ishte arsyeja?</li> </ul> |
| <p><b>Shënim:</b> Në faqen e mëposhtme <a href="http://www.food.gov.uk/multimedia/flash/a_balanced_plate_intro.swf">http://www.food.gov.uk/multimedia/flash/a_balanced_plate_intro.swf</a></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● gjendet një lojë ku nxënësit duhet të ndajnë ushqime të ndryshme nëpër grupe ushqimore. Ajo mund të përdoret për ilustrim në klasë.</li> <li>● - Në klasë ndërtohet një poster ku të përfshihet fjalori apo gjuha e përdorur që lidhet me tematikën “Kujdesi për veten”. Kjo do t'u mundësojë nxënësve që të plotësojnë në fletën murale për çdo temë të re të kapitullit fjalët e reja. Diskutohet me gjithë klasën rreth kuptimit të tyre.</li> </ul>  |  |



Ora 2

| Fusha: Shkencë  | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
|---|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Dieta e shëndetshme   |                      | <b>Situata e të nxënësve:</b> Shijojmë fruta e perime                                   |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.</p> <p>Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.</p> <p>Tregon interes kur kërkon informacion dhe bën pyetje për ushqimet që dëmtojnë shëndetin e njeriut.</p> <p>Kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një dietë e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm.</p> <p>Tregon se kafshët, përfshirë njeriun, kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.</p>  |                      |   |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkon dhe studion dietën e duhur dhe të larmishme që nevojitet për të qenë i shëndetshëm.</li> <li>• Mbledh prova të llojeve të ndryshme për t'u përgjigjur pyetjeve dhe për të vërtetuar hipotezat.</li> </ul>   |                      | <p><b>Fjalë kyçe:</b> dietë, ushqehem, piramida ushqimore, dhimbje koke, dehidratim</p> |      |
| <p> <b>Kujdes!</b> Përpara se të nisni këtë veprimtari, ju duhet të përgatitjen e ushqimit. Gjithashtu, ju duhet të kontrolloni për ndonjë alergji të mundshme. Sigurohuni që, para se të hanë, nxënësit të ndjekin rregullat e higjenes dhe të lajnë duart. Gjithashtu, ata duhet të përdorin secili lugën e tij, mundësisht të jetë plastike. Pastroni me dizinfektues çdo sipërfaqet para se të punoni me ushqimet.</p>   |                      |   |      |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <p><b>Mjetet:</b> fruta dhe perime të ndryshme, pjata, thika dhe pirunë plastike, disinfektues</p>   |                      | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Biologji), Arte</p>                       |      |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Nxënësit në dyshe për pak minuta i tregojnë njëri-tjetrit përfundimet e detyrave të shtëpisë (fleta e punës 2.1), ndërkohë që veprimtaria ndiqet në të gjitha tavolinat.</p> <p><i>Prezantohet</i> Piramida Ushqimore dhe si është e organizuar ajo.</p> <p>Diskutohet situata në të cilën është vendosur Joni, i cili duket sikur nuk ka dëshirë ta provojë kavin, për shkak të pamjes së tij. Por pasi e provon, kupton se i pëlqen. A ka ndodhur të provoni fruta që nuk kanë pamje të bukur por kanë shije të mirë? Orientohen nxënësit të kuptojnë se gjatë kohës që ata rriten edhe shijet ndryshojnë. Ne mund të mësojnë të pëlqejnë gjëra të reja, prandaj është mirë që të provojmë fruta dhe perime të reja, qoftë edhe në sasira të vogla.</p> |                      |   |      |

**Hulumtim:** Pyeten nxënësit se cilat janë frutat dhe perimet që u pëlqejnë, ose cilat janë ato që nuk i kanë provuar ndonjëherë? Prezantohet veprimtaria hulumtuese që do të zhvillojnë nxënësit në dyshe. Pasi janë përgatitur në pjata copa frutash e perimesh nxënësit do të provojnë dhe do të hedhin në një tabelë të ngjashme me atë të librit rezultatet e provave.

**Përfundimet e hulumtimit:** Pas disa provave diskutohet me të gjithë nxënësit e klasës mbi rezultatet e hulumtimit të tyre.

Drejtohen pyetje si: pse duhet të hamë sa më shumë fruta e perime? Pse trupi ynë ka nevojë për ujë? A keni ngrënë ndonjëherë ushqime që nuk u pëlqejnë, vetëm sepse janë të shëndetshme? Çfarë mendoni se është më e rëndësishme, të hanë ushqime që kanë shije të mirë, apo ushqime që i bëjnë mirë organizmit. A ekzistojnë ushqime të shijshme dhe që i bëjnë mirë organizmit tonë? Çfarë do të ndodhte nëse do të hanim vetëm ëmbëlsira të shijshme?

Nxënësit individualisht plotësojnë fletën e punës 2.2 b dhe e diskutojmë së bashku me klasën arsyet e zgjedhjeve të bëra.

- Kërkohet prej nxënësve të vlerësojnë të ushqyerin e tyre duke shkruar dy gjëra të shëndetshme nga ato që bëjnë. Për shembull, 'Unë ha shumë fruta' ose 'Unë pi ujë çdo vakt'. Më pas kërkoni prej tyre të shkruajnë fjali që fillojnë me 'Unë do të ...', për të treguar synimet e tyre për të ardhmen. Për shembull 'Unë do të ha më pak ëmbëlsira' ose 'Unë do të ha fruta të freskëta çdo ditë'. Nxënësit me dëshirë mund ta tregojnë reflektimin e tyre para klasës.

**Vlerësimi:** Kompozimi i një vakti të shëndetshëm.

- Kërkohet prej nxënësve të vlerësojnë të ushqyerin e tyre duke shkruar dy gjëra të shëndetshme nga ato që bëjnë. Për shembull, 'Unë ha shumë fruta' ose 'Unë pi ujë çdo vakt'. Më pas kërkohet prej tyre të shkruajnë fjali që fillojnë me 'Unë do të ...', për të treguar synimet e tyre për të ardhmen. Për shembull 'Unë do të ha më pak ëmbëlsira' ose 'Unë do të ha fruta të freskëta çdo ditë'.

**Detyra:** Punimi i detyrës së fq. 13 të Fletores së Punës.

Nxënësit do të mbajnë një ditar ushqimor ku të shënojnë vaktet dhe mesvaktet për disa ditë. Për këtë mund të përdorin fletën e punës 2.2 a.

- **Refleksion:** Nxënësit mund të reflektojnë mbi të ushqyerin e tyre dhe të propozojnë disa ide se si mund të bëjnë atë më të shëndetshme.

**Shënim:** Diskutimi i Ditarit ushqimor do të bëhet orën e ardhshme.

### Ora 3

| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
|--|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Dieta e pashëndetshme  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> E shëndetshme apo e pashëndetshme |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>  |                      |   |      |
| Tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.        |                      |   |      |
| Tregon interes kur kërkon informacion dhe bën pyetje për ushqimet që dëmtojnë shëndetin e njeriut.           |                      |   |      |
| Kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një dietë e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm. |                      |   |      |

|   |   |
|---|---|
| <p>Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.</p>   |   |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/>Mëson se ushqimet me shumë sheqer apo me shumë yndyrna janë të dëmshme për shëndetin tonë.<br/>Ngre hipoteza, bën parashikime dhe i shpalos ato.</p>  | <p><b>Fjalë kyçe:</b> shënoj, kripë, diskutoj</p>                     |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br/><b>Mjetet:</b> një pije me shumë sheqer, ujë, lëvozhga vezësh, dy gota plastike</p>  | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Shkencat (Kimi, Biologji)</p> |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ditar dypjesësh: Prezantim i dietave ushqimore të hartuara nga nxënësit si detyrë shtëpie. Gjatë prezantimit në tabelë hidhen disa prej dietave më të spikatura.</li> <li>• Ftohen nxënësit të krahasojnë sasinë e sheqerit në pije të ndryshme në veprimtarinë 2.3 a në libër.</li> <li>• <i>Hetim:</i> Ndahen nxënësit në grupe dhe organizohen me mjetet e nevojshme për eksperimentin. (pije të ndryshme në etiketën e të cilave shënohen vlerat ushqyese.) Përdoren dy enë ku në njërin hidhet pije me sheqer dhe në tjetrën ujë. Pastaj vendosin nga një lëvozhgë veze në secilën prej tyre. Sqarohen nxënësit se për të parë rezultatet do të nevojiten disa ditë. Pas disa ditësh do të vihet re se lëvozhgat që ndodhen brenda pijeve me sheqer do të bëhen të buta dhe elastike, ndërsa ato brenda në ujë do të jenë ende të pastra dhe të forta. Mundet që disa prej enëve të lëshojnë erë të pakëndshme, prandaj mbulojeni secilën prej tyre me letër ose kapak. Nxiten nxënësit të bëjnë një lidhje logjike midis ndikimit që pati sheqeri mbi lëvoret e vezëve dhe ndikimit që ai mund të ketë mbi dhëmbët. Kërkohet prej nxënësve të arsyetojnë se çfarë ndodh me dhëmbët nëse konsumojmë shumë sheqer. Shumë nxënës mendojnë se dëmtimi i dhëmbëve të fëmijërisë nga sheqeri i tepërt nuk është shumë i rëndësishëm, pasi më vonë këta dhëmbë do të bien dhe në vend të tyre do të mbijnë të rinj. Nxënësit duhet ta kenë të qartë se dhëmbët e tyre të pjekurisë e fillojnë zhvillimin që në vegjëli dhe sasia e tepërt e sheqerit do t'i dëmtonte ata, pa dalë ende në sipërfaqe.</li> </ul> <p><i>Bisedë:</i> me nxënësit rreth ushqimeve të tyre të preferuara dhe veçoni prej tyre ushqimet të cilat mendoni se janë të shëndetshme për organizmin. Diskutohet se si shija e ëmbël e ushqimeve me sheqer shton dëshirën për t'i konsumuar më shumë ato dhe se si sheqeri përdoret gjatë përgatitjes së ushqimeve të përpunuara, për t'u dhënë atyre shije të ëmbël. Gjithashtu edhe ngjyrat e ndezura që përdoren në paketime apo reklama, janë për t'i bërë ushqimet më tërheqëse. Madje, në treg qarkullojnë shumë ushqime të pashëndetshme, reklamat e të cilave kanë në shënjestër fëmijët.</p> |   |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vlerësimi:</b> A janë nxënësit në gjendje të përshkruajnë efektin që ka sasia e tepërt e sheqerit në dietën e tyre?</li> <li>• A janë ata në gjendje të vlerësojnë mënyrën se si e kanë zhvilluar këtë veprimtari, duke përshkruar dy gjëra për të cilat mendojnë se i kanë bërë mirë dhe një gjë të cilën do të donin ta përmirësonin.</li> </ul>  |   |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 11 Fletore Pune<br/>Ushtrimi 2.3 në <i>Fletë pune</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit mund të mbajnë një ditar për larjen e dhëmbëve, ku të shënojnë çdo ditë kohën kur i lajnë dhëmbët, kohëzgjatjen e këtij veprimi dhe nëse kanë përdorur ose jo pastë dhëmbësh.</li> </ul>  | <p><b>Refleksion:</b> Çfarë ndodh me dhëmbët nëse konsumojmë shumë sheqer?</p> |
| <p><b>Shënim:</b> Vëzhgimet e hetimit do të vazhdojnë dhe në orët në vazhdim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në faqen: <a href="http://www.childrensuniversity.manchester.ac.uk/interactives/science/teethandeating/">www.childrensuniversity.manchester.ac.uk/interactives/science/teethandeating/</a> 74 nxënësit mund të mësojnë më shumë për dhëmbët dhe kujdesit ndaj tyre (përfshirë mënyrën e duhur për t'i larë).</li> <li>Për më shumë informacion në lidhje me historinë e sëmundjes së Skorbutit mund t'i hidhni një sy faqes: <a href="http://askbiologist.asu.edu/explore/sailors-called-limeys">http://askbiologist.asu.edu/explore/sailors-called-limeys</a>.</li> </ul> |  |

## Ora 4

| Fusha: Shkencë  | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3  | Data |
|---|----------------------|--|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Ushtrimet fizike dhe gjumi  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Ç'ndodh me trupin tonë?      |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>   |                      |  |      |
| <p>Kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një diete e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm.</p> <p>Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë</p>   |                      |  |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <p>Kërkon dhe studion llojet e ushtrimeve dhe dietën e duhur e të larmishme, që nevojitet për të patur një trup të shëndetshëm.</p> <p>Mbledh prova të llojeve të ndryshme për t'ju përgjigjur pyetjeve dhe vërtetuar hipotezat.</p> <p>Vëzhgon dhe krahasojmë sendet, gjallesat dhe dukuritë.</p>  |                      | <p><b>Fjalë kyçe:</b> ushtrime fizike</p>                |      |
| <p><b>Burimet:</b> hapësirë e madhe</p> <p><b>Mjete:</b> fletë pune, kronometër</p>   |                      | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Edukim Fizik</p> |      |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Brainstorming:</i> Shkruhet në tabelë “Ushtrime fizike” Pyeten nxënësit se çfarë dinë për to? Pasi merren përgjigjet e nxënësve dhe shkruhen në tabelë nxënësit ftohen të zhvillojnë një hetim. Ata do të hetojnë se si ndikojnë ushtrimet fizike në trupin e njeriut.</p> <p>Hetim: Organizohen nxënësit në dyshe me qëllim që të vëzhgojnë me radhë njëri-tjetrin. Sqarohen nxënësit se duhet të vëzhgojnë shpejtësinë e frymëmarrjes, ritmin e rrahjeve të zemrës dhe ndjesinë e lëkurës së tyre, para se të fillojnë me ushtrimet. Këto të dhëna do t'i shënojnë në fletore. Gjithashtu sugjerohet që të parashikojnë disa prej rezultateve. Fillimisht nxënësit qëndrojnë të ulur dhe shkruajnë në fletore të dhënat si dhe parashikimet mbi gjendjen e trupit. Drejtuar nga mësuesja fillojnë të kryejnë ushtrime të ndryshme (p.sh. lëvizje të duarve, këmbëve, vrapim në vend, kërcime). Me sinjalin e mësueses ndalojnë dhe vëzhgojnë gjendjen e trupit sipas parametrave të vëzhguar para zhvillimit të ushtrimeve. Në dyshe bëjnë krahasime me përfundimet e nxjerra dhe nga shokët.</p> |                      |  |      |

**Diskutim:** Diskutohen së bashku përfundimet e hetimit; Ç'ndodhi me rrahjet e zemrës, me frymëmarrjen, po lëkura ndryshoi? Shpjegohet se çdo lloj aktiviteti që rrit numrin e rrahjeve të zemrës, është i dobishëm për trupin. Këtu bëjnë pjesë edhe lojërat sportive, ecja, pedalmi, madje dhe larja e makinës apo të punuarit në kopsht.

Diskutimi vazhdon rreth orarit kur flenë në mbrëmje dhe orës që zgjohen në mëngjes.

Llogarisin sa orë gjumë fle gjithsecili. A arrijnë ata t'i mbushin 10-12 orët e rekomanduara të gjumit? A shkojnë herët në shtrat gjatë ditëve që kanë mësim? Nxënësit do të përshkruajnë se si ndihen kur janë të lodhur. A ndikon lodhja në uljen e përqendrimit gjatë mësimt?

Punohet në mënyrë të pavarur nga nxënësit ushtrimet 1 dhe 2 të mësimt dhe të ushtrimeve 2.4 a dhe 2.4 b të fletëve të punës.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në Fletët e punës dhe në ushtrimin 2 të librit.

**Detyra:** Punimi i fq. 15 Fletore Pune

**Refleksion:** Cila është ora më e përshtatshme për të fjetur?

**Shënim:** Nxënësit mund të përdorin aparatën fotografik për të fotografuar veten para dhe pas ushtrimeve.

## Ora 5

| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3                        | <b>Data</b>   |
|--|-----------------------------|---------------------------------------|---|
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 1)  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Unë di... |   |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>  |                             |                                       |   |
| Tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.  |                             |                                       |   |
| Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.  |                             |                                       |   |
| Tregon interes kur kërkon informacion dhe bën pyetje për ushqimet që dëmtojnë shëndetin e njeriut.   |                             |                                       |   |
| Kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një dietë e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm.   |                             |                                       |   |
| Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.   |                             |                                       |   |
| Kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një diete e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm.   |                             |                                       |   |
| Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.  |                             |                                       |   |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>   |                             |                                       | <b>Fjalë kyçe:</b> proteina, yndyrë, karbohidrate, sheqer, dhëmbë, energji      |
| Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara.<br>Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimit e fituara. |                             |                                       |   |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi  |                             |                                       | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br>Shkencat (Kimi Biologji)<br>Art (Art pamor) |
| <b>Mjetet:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra  |                             |                                       |   |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

*Lojë me top e fjalë:* Ftohen nxënësit të shohin fjalët e reja të afishuara në faqen e murit gjatë gjithë këtyre grup temave. Secili nxënës sipas dëshirës zgjedh një fjalë. Këtë fjalë ia thotë shokut të cilit i pason topin e tenisit. Ai që pret topin thotë një fjali me këtë fjalë ku të tregojë diçka që ka mësuar nga këto mësimet. Nxënësi që ka topin thotë një fjalë tjetër dhe e pason topin. Nxënësi që e pret formulon fjalinë, kështu vazhdohet deri sa të përdoren të gjitha fjalët (ose në varësi të kohës).

*Punë e pavarur:* Ftohen nxënësit të punojnë individualisht Fletën e punës 2.5 dhe fq. 24 dhe 25 të librit.

Nxënësit të organizuar në grupe (gr. 1 dhe gr. 2) do të ndërtojnë nga një fletëpalosje/poster. Grupi 1 do të paraqesë metodën që duhet ndjekur për të qenë të shëndetshëm. Ajo mund të përfshijë rregulla në lidhje me dietën, ushtrimet, ujin dhe gjumin. Grupi 2 do të paraqesë metodën që duhet ndjekur për t'u kujdesur për një bimë në mënyrë të shëndetshme. Ajo mund të përfshijë përshkrim të bimës, rregulla në lidhje me kujdesin ndaj saj.

*Ekspozim i punimeve:* Nxënësit mund t'i vlerësojnë punimet bashkërisht duke i krahasuar, duke shtuar gjëra të reja, apo duke propozuar ide për t'i përmirësuar ato.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.

**Detyra:** Punimi i fq. 15 Fletore Pune

**Refleksion:** Cili prej hetimeve të kryera gjatë këtyre temave t'u duk më interesant? Pse?

**Shënim:** Të njëjtën temë të punës së grupit mund ta kenë njëkohësisht disa grupe. Pyetja e refleksionit mund t'i jepet nxënësve ta punojnë në shtëpi. Sqarohen nxënësit se zgjedhja e mënyrës së prezantimit mund të jetë sipas dëshirës.

**Ora 6**

| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>                        | <b>Data</b> |
|---|-----------------------------|---------------------------------------|-------------|
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 2)<br>Detyrë përmbledhëse/Test   |                             | <b>Situata e të nxënët:</b> Unë di... |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Dallon se bimët kanë rrënjë, kërcell, gjethe dhe lule.</p> <p>Shpjegon nga vëzhgimet se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten.</p> <p>Përshkruan si uji thithët nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit.</p> <p>Argumenton se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcel dhe gjethe që të rriten mirë.</p> <p>Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar për çfarë kanë nevojë bimët.</p> <p>Eksploron rolin e lules në ciklin jetësor të një bime.</p> <p>Tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.</p> <p>Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.</p> <p>Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.</p> |                             |                                       |             |

|   |   |
|---|---|
| <p>Kryen kërkime se si ushtrimet fizike dhe një diete e larmishme janë të nevojshme për të qenë të shëndetshëm.</p> <p>Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.</p>  |   |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/>Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara.</p>  | <p><b>Fjalë kyçe:</b> ujë, rrënjë, kërcell, gjethe, lule, transporton, e shëndetshme, të pashëndetshme, proteina, yndyrë, karbohidrate, sheqer, dhëmbë, energji</p> |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi<br/>Mjete: fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra</p>   | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Kimi Biologji) Art (Art pamor)</p>  |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br/>Nxënësit <i>prezantojnë</i> mbresat e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë.<br/><i>Punë e e pavarur:</i> Plotësimi i detyrave përmbledhëse.<br/><i>Lojë në dyshe:</i> Dy të sakta dhe një e gabuar. Nxënësit mund të tregojnë dy gjëra të sakta dhe një të gabuar (nga mësimet e trajtuara), tjetri do të gjejë të saktat dhe gabimin. Më pas këmbëjnë rolet.</p> |   |
| <p><b>Vlerësimi:</b></p>  |   |
| <p><b>Detyra:</b> Vlerësohen për punimin e Detyrës përmbledhëse/Testit.</p>   | <p><b>Refleksion:</b></p>   |
| <p><b>Shënim:</b> Kjo orë mund të shfrytëzohet si tesim ose si detyrë përmbledhëse e tremujorit të parë.</p>  |   |

## Kapitulli 3: Gjallesat

### Ora 1

|  |                             |  |             |
|--|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Gjallesat dhe jo gjallesat   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Është gjallesë apo jogjallesë?                       |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit, që të jetojnë.   |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Përshkruan ndryshimet midis gjallesave dhe jogjallesave, duke përdorur njohuritë mbi proceset jetësore.  |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> marr frymë, të vegjël, rritem, nxjerr, procese jetësore, ndaj |             |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjetet:</b> tabak letre, lapsa, figura gjallesash dhe jogjallesash.  |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Biologji), Arte                       |             |
| <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br>Nxënësve ju prezantohen disa sende të përzgjedhura (fotografi kafshësh të ndryshme apo objektesh të marra nga mjedisi ku jetojmë)<br><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> A janë të gjalla ato çfarë tregon fotografia? Cila është arsyeja që ata mendojnë se shembujt e paraqitur janë ose jo gjallesa? Nxënësit do të argumentojnë mendimet e tyre. Ndërkohë në tabelë vizatohen dy rrahtë brenda të cilëve shkruhen emërtimet të gjalla jogjallesa.<br><i>Prezantimi i mësimi:</i> Pyetini nxënësit nëse janë dakord me nxënësit e paraqitur në figura? A janë në gjendje të shpjegojnë se çfarë thonë ata? Ç'mendim kanë për bimën, bletën, vazon e lules dhe tavolinën? Në setin tjetër të fotografive gjallesat janë: zogu, pema, kandili i detit dhe flutura. Jogjallesat janë: fija e shkrepëses, statuja, raketa dhe kompjuteri. Shpjegohet se zjarri nuk është gjallesë, sepse ai nuk mund të riprodhohet. Rritja e tij ndodh vetëm për një kohë të shkurtër dhe zhduket me të mbaruar lënda djegëse. Mund të duket sikur ai 'sekretion' (nxjerrë) tym, gjë e cila edhe kjo mund të na ngatërrojë.<br><i>Organizuesi grafik:</i> Shpjegohet se, ashtu si shkencëtarët edhe ata duhet të hetojnë dhe të krijojnë një listë kontrolli, ku të shënojnë të gjitha karakteristikat e gjërave të gjalla. Nxënësit plotësojnë në dyshe tabelën me karakteristikat që mendojnë ata se kanë, më pas punojnë në grupe të vogla ku ballafaqojnë me njëri-tjetrin mendimet e veta dhe më pas t'i shpalosin ato. Me mjetet që kanë marrë, nxënësit bëjnë ndarjen në gjallesa dhe jogjallesa. Krahasojnë mendimet me listën që gjendet në faqen 27 të librit.<br>Më pas plotësohen fletët e punës 3.1 a, 3.1 b dhe 3.1 c. Diskutohen në dyshe.<br><i>Shikim:</i> shfaqja e një video me pamje gjallesash dhe jogjallesash. |                             |  |             |
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit duke kërkuar prej tyre të grupojnë gjallesat dhe jogjallesat. Vlerësohen duke parë nëse janë në gjendje t'i arsyetojnë këto grupime, duke u bazuar në shtatë proceset jetësore.  |                             |  |             |



|   |  |
|---|--|
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 17 të Fletores së Punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Me dëshirë mund të bëjnë një album me figura të organizuar në gjallesat dhe jogjallesat.</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Refleksion:</b> A ishte e vështirë të arrije në përfundime?</li> </ul> |
| <p>Shënim: Për orën në vazhdim nxënësve do të sjellin në klasë fotografi të tyre kur kanë qenë më të vegjël dhe kur kanë qenë ende bebe.</p> <p>- Në klasë ndërtohet një poster ku të përfshihet fjalori apo gjuha e përdorur që lidhet me tematikën “Gjallesat”. Kjo do t’u mundësojë nxënësve që të plotësojnë në fletën murale për çdo temë të re të kapitullit fjalët e reja. Diskutohet me gjithë klasën rreth kuptimit të tyre.</p> |  |

**Ora 2**

|  |                             |   |   |
|--|-----------------------------|---|---|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>                              | <b>Data</b>   |
| <b>Tema mësimore:</b> Rritja dhe ushqyerja e gjallesave  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Ushqejmë zogjtë |   |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.</p> <p>Krahason dieta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë.</p>   |                             |   |   |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <p>Përshkruan ndryshimet midis gjallesave dhe jogjallesave, duke përdorur njohuritë mbi proceset jetësore.</p> <p>Njeh proceset jetësore, që janë të përbashkëta te njerëzit dhe kafshët, ku përfshihet të ushqyerit (uji dhe ushqim), lëvizja, rritja dhe riprodhimi.</p>   |                             |   | <b>Fjalë kyçe:</b> i rritur ushqej                                    |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <p><b>Mjete:</b> enë plastike, spango, yndyrë, fara për zogjtë</p>  |                             |   | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Biologji), Art, Teknologji |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Bisedë</i> tregojmë për veten: Nxënësit në dyshë për pak minuta i tregojnë njëri-tjetrit fotot që kanë sjellë me vete. Ata tregojnë rreth fotos dhe çfarë mbajnë mend rreth asaj kohe. Disa nxënës që dëshirojnë dalin para klasës dhe tregojnë.</p> <p>Prezantohen para klasës foto dhe u kërkohet nxënësve të flasin rreth tyre. Fillimisht tregohen foto të kafshëve të ndryshme dhe emërtohen ato të vogla dhe kur rriten. Prezantohen gjithashtu dhe fazat e rritjes së bimës.</p> <p>Diskutohet mbi mënyrën e të ushqyerit të bimëve dhe të kafshëve. Njihen me grupimin e kafshëve sipas të ushqyerit.</p> <p><i>Ditari dypjesësh:</i> Duke marrë shembujt e fotove plotësohet në tabelë Ditari dypjesësh.</p> <p>Në njërën kolonë shënohen emërtimet e grupimeve (barngrënëse, mishngrënëse dhe gjithçkangrënëse) dhe në krah emrat e kafshëve që i përkasin këtij grupimi.</p> <p>Demonstrohet bërja e një ushqyesi për kafshët duke ndjekur hapat e prezantuar te veprimtaria në libër ose në fletën plotësuese 3.2.</p> <p>Diskutim: Përmendni disa nga kafshët që njihni. Me se ushqehen ato?</p> |                             |   |   |
| <p><b>Vlerësimi:</b> A janë në gjendje nxënësit të flasin rreth fazave të rritjes të kafshët dhe bimët? A mund të përcaktojnë grupet ku bëjnë pjesë kafshët bazuar në të ushqyerit e tyre?</p>   |                             |   |   |

|   |  |
|---|--|
| <b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 18 të Fletores së Punës.   | <b>Refleksion:</b> Kërkohet prej nxënësve të përmendin dy gjëra të cilat mendojnë se i kanë bërë mirë këtë mësim dhe një gjë për të cilën mendojnë se duhet përmirësuar. |
| <b>Shënim:</b> Nëse kushtet e klasës nuk e mundësojnë përgatitjen e një ushqyesi për kafshët nga vetë nxënësit, Ata udhëzohen që me ndihmën e një të rrituri mund ta përgatitin në shtëpi. Në faqen: <a href="http://www.fossweb.com/modulesK2/NewPlants/index.html">http://www.fossweb.com/modulesK2/NewPlants/index.html</a> . Nëse shtypni butonin ‘vëzhgo rritjen’, mund të përzgjidhni pesë fara për të ‘mbjellë’ në kopsht. Fazat nëpër të cilat kalon rritja e bimëve janë të ilustruara. Gjithashtu, kenë edhe alternativën e të mësuarit mbi rrënjët, kërcellin dhe gjethet, gjë që përforcon njohuritë e marra në Kapitullin 1. |  |

## Ora 3

|   |                             |  |             |
|---|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Riprodhimi dhe lëvizja e gjallesave   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Ndërtojmë një model me pjesët e lëvizshme të trupit. |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.<br>Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.  |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Mëson se proceset e zakonshme jetësore të njerëzimit dhe kafshët, përfshijnë të ushqyerit (ushqimi dhe uji), lëvizjen, rritjen dhe riprodhimin.   |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> riprodhoj, mbart, pasardhës                                   |             |
| <b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br><b>Mjetet:</b> një model me pjesët e trupit, gjilpëra me kokë  |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br>Shkencat (Kimi, Biologji)                    |             |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Nxënësve u paraqiten foto kafshësh ku të jenë të paraqitura me të vegjlit e tyre. Drejtohen pyetjet: Çfarë shihni në foto? Si quhen këto kafshë? Ku jetojnë ato? Çfarë dini rreth tyre?<br>Njihen nxënësit me faktin se çdo gjallesë riprodhohet dhe krijon pasardhësit e saj. Kjo është pjesë e proceseve të jetës.<br>Ftohen nxënësit të shohin figurën e fq. 31 të librit. Çfarë po bëjnë fëmijët? A lëvizin kafshët? Po bimët?<br>Lexohet dhe diskutohet informacioni që jepet në libër mbi mënyrën se si lëvizin bimët.<br><i>Veprimtari:</i> Të organizuar në dyshe nxënësit punojnë për ndërtimin e një modeli të pjesëve të lëvizshme të trupit të njeriut. Përdoret fleta plotësuese 3.3 për të përgatitur modelin. Dyshet tregojnë modelin e përfunduar dhe krahasojnë se si lëvizin kyçet në model me ato të një njeriu që lëviz.<br><i>Diskutohen</i> pyetjet e rubrikës së librit për t'i dhënë përgjigje. |                             |  |             |
| <b>Vlerësimi:</b> A janë nxënësit në gjendje të shpjegojnë se si dhe pse lëvizin kafshët dhe bimët? Nxënësit mund të vetvlerësojnë modelin e pjesëve të lëvizshme të trupit. Si lëvizin “kyçet” tek ai?   |                             |  |             |
| <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 19 Fletore Pune   |                             | <b>Refleksion:</b> Si lëvizin gjymtyrët në trupin tuaj?                          |             |

**Shënim:** Mësuesja ka gati disa modele të trupit të njeriut, të cilat do të shërbejnë si shabllone për të krijuar vetë nxënësit modelet e tyre.

- Në faqen: <http://www.haworth-village.org.uk/nature/time-lapse/thumbs.asp> Në të gjenden disa sekuenca filmike të rritjes së një bime. Si për shembull, një Iris duke çelur ose një bizele duke mbirë.

**Ora 4**

|  |                             |  |             |
|--|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Skeleti  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Ku ndodhen kockat në trupin tonë?                              |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.<br>Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriu kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.  |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Dallon skeletin si strukturë e trupit të njeriut dhe kafshëve.<br>Njeh grupimet e kafshëve si rezultat e të pasurit ose jo skelet.   |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> skelet, strukturë, kocka, jorruazor, kafkë, shtyllë kurrizore, vertebër |             |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi  |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b>   |             |
| <b>Mjetet:</b> model skeleti (model mësimor) njeriu ose kafshe   |                             | Shkencat (Kimi, Biologji)  |             |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br>Diskutim i përfundimeve të detyrave të shtëpisë. Rikujtim i grupimit të kafshëve sipas mënyrës së të ushqyerit.<br><i>Shpjegim i përparuar:</i> Prezantohet para nxënësve fakti se ashtu si kafshët grupohen nga mënyra e të ushqyerit ato grupohen dhe nëse kanë apo jo skelet. Skeleti është strukturë e fortë, që e mban dhe e mbron trupin. Ai i jep formë trupit, mbron organet e tij dhe e mban të fortë. Demonstron skeleti (model mësimor). Prezantohen dhe figurat në libër. Diskutohet mbi dallimin që vënë re nxënësit ndërmjet figurave të fq. 32 (skeletet) dhe figurës së kandilit të detit. A shihet te kandili i detit skelet? Njohja me emërtimet e dy grupimeve: rruazorë dhe jorruazorë.<br>A e keni dëgjuar se nga se përbëhet skeleti? Skeleti përbëhet nga kockat të cilat mund t'i ndjejmë poshtë lëkurës.<br><i>Hetim:</i> Lexohen njëkohësisht me nxënësit hapat e veprimtarisë “Ku ndodhen kockat në trupin tonë?” dhe bëhen provat për të gjetur secili në trupin e tij kockat e skeletit.<br><i>Diskutojnë</i> nxënësit në dyshe përgjigjet e pyetjeve: Pse skeletet duhet të jenë të forta? Pse kockat e skeletit kanë forma dhe përmasa të ndryshme? Kockat nuk janë shumë të rënda. A i ndihmon kjo gjë kafshët? Përgjigjet e gjetura nxënësit i diskutojnë më pas me gjithë klasën. |                             |  |             |
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfshirjen dhe përdorimin e fjalëve të fjalorit në përputhje me temën.   |                             |  |             |
| <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 20 Fletore Pune<br>Me dëshirë nxënësit mund të gjejnë emra e foto kafshësh të tjerë të cilat nuk kanë skelet.  |                             | <b>Refleksion:</b> Si u ndjetë me provat e hetimit?  |             |
| <b>Shënim:</b>   |                             |  |             |

## Ora 5

|   |                             |   |             |
|---|-----------------------------|---|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>  | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Muskujt   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Provojmë muskujt                          |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.<br>Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.  |                             |   |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Dallon disa muskuj të trupit të njeriut.<br>Mëson si funksionojnë muskujt për të ndihmuar trupin.   |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> muskuj, mblidhet, lëshohet                         |             |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjetet:</b> një objekt i rëndë, p.sh., një libër i madh   |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Kimi, Biologji)            |             |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br><i>Lojë:</i> Me gjithë nxënësit e klasës zhvillohet loja “Gjiganti shkurtabiqi”. Pyeten nxënësit: Si u ndjetë? Ç’pjesë të trupit lëvizët? Si lëvizët? Çfarë ju ndihmoi për të lëvizur?<br><i>Shpjegim i përparuar:</i> Sqarohen nxënësit se janë muskujt ata që ndihmojnë skeletin e trupit të lëvizë. Muskujt janë të lidhur me kockën. Gjatë veprimit të tyre ata mblidhen ose lëshohen. Vëzhgohen figurat e fq. 34 të librit dhe shpjegohet mënyra se si funksionojnë muskujt.<br><i>Hetim:</i> Hetojmë mënyrën se si funksionojnë muskujt tanë. Lexohen njëkohësisht me nxënësit hapat e veprimtarisë “Provojmë muskujt” dhe bëhen provat. Drejtohen pyetjet: A i ndjetë muskujt e krahut tuaj? Ndryshonin në formë ata? Si ndodhte? Nxiten nxënësit të tregojnë procesin si vepruan dhe çfarë ndodhi njëkohësisht me muskujt. Tërhiqet vëmendja në përdorimin e drejtë të fjalëve “muskuli mblidhet” dhe “muskuli lëshohet”. Punohet në dyshe me pyetjet e dhëna në mësim. Ftohen nxënësit të japin mendime rreth zemrës dhe funksionimit të saj si muskul. |                             |   |             |
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfshirjen dhe përdorimin e fjalëve të fjalorit në përputhje me temën. Për pjesëmarrjen në hetim dhe mendimet rreth përfundimeve.   |                             |   |             |
| <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 21 Fletore Pune   |                             | <b>Refleksion:</b> Në fund të kësaj ore a i ndjetë muskujt të lodhur? |             |
| <b>Shënim:</b> Kjo lojë drejtohet nga mësuesja deri në një kohë të caktuar. Nuk është e nevojshme të dalë fituesi sepse qëllimi i saj është të bëjë nxënësit të kuptojnë se për lëvizjen e trupit të tyre ata po përdorin muskujt.  |                             |   |             |

## Ora 6

|  |                             |  |             |
|--|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Të ngjashëm dhe të ndryshëm  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Më shumë ngajmë apo ndryshojmë?                        |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj. |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Ndan gjallesat në grupe duke përdorur tipare të thjeshta dhe jep shpjegime të arsyeshme për këto grupime.                    |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> i ngjashëm, i ndryshëm, shenjat e gishtave, përcaktoj, të dhëna |             |

|  |  |
|--|--|
| <b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.  | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b>                         |
| <b>Mjetet:</b> letër, tabelë, laps   | Matematikë   |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Bisedë:</i> Nxënësit ftohen të tregojnë se nga se ndryshojnë nga shokët e tyre. (ngjyra e syve, ngjyra e flokëve, gjatësia, etj.) Më pas të tregojnë ngjashmëritë me shokët e tyre. (hanë ushqim, pinë, veshin këpucë, etj.)</p> <p>Diskutohet së bashku me nxënësit rreth figurës së fq. të librit. Nxënësit tregojnë ndryshimet ndërmjet fëmijëve në figurë e më pas ngjashmëritë ndërmjet tyre.</p> <p>Pyeten nxënësit nëse dinë gjë për gjurmët e gishtërinjve. Sqarohen se ato janë unikale, secili i ka të ndryshme nga tjetri. Vetëm një njeri dhe askush tjetër e ka atë formë të gjurmës së gishtit.</p> <p><i>Hetim:</i> Me ndihmën e zmadhuesit nxënësit mund të shohin formën në gishtin tregues të tyre dhe të shokut, duke i krahasuar ato. Me një pambuk me bojë lyhet gishti tregues dhe vendoset në fletë gjurma e gishtit me radhë për çdo grup me nga 4 veta. Nxënësit brenda grupit krahasojnë format e gjurmëve të gishtave të tyre në fletë. Në ndihmë ju vjen fleta e punës 3.4 a.</p> <p><i>Mbledhja e të dhënave:</i> Të organizuar në grupe nxënësve sipas grupit ju jepet detyrë mbledhja e të dhënave të orientuar me fletët e punës 3.4 b, dhe sipas tabelave të dhëna në libër. Njëri grup do të tregojë të dhënat për përfaqësuesit e tij në lidhje me: Ngjyra e flokëve, Ngjyra e syve, Gjatësia (në m dhe cm). Grup tjetër do të mbledhë dhe paraqesë të dhënat në lidhje me: Ngjyra e flokëve, kafe, e zezë, e verdhë. Pas kohës së caktuar përfaqësuesit e grupeve prezantojnë rezultatet. Hartohet grafiku i përgjithshëm 3.4 Fleta e punës.</p> <p><i>Përfundime:</i> Kush është më i gjatë? Kush është më i shkurtër? Çfarë ndryshimesh kanë njëra nga tjetra bebet e sapolindura?</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> A janë në gjendje nxënësit t'i grupojnë njerëzit në bazë të karakteristikave të dukshme?</p> <p>Nxënësit do të vlerësojnë punën e njëri-tjetrit (Sa të qarta janë kriteret e përdorura për dikë që vjen nga jashtë dhe i sheh këto grupime?).</p>   |  |
| <b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 22 të Fletores së Punës.  | <b>Refleksion:</b> Pjesë e cilit grup ishe? Si u ndjeve? |
| <p><b>Shënim:</b> Grupe të ndryshme mund të kenë të njëjtat të dhëna për të mbledhur dhe paraqitur në tabelë.</p> <p>Mund të duhet t'u rikujtohet nxënësve se si ndërtohet një tabelë përmbledhëse të dhënash.</p> <p>Plotësimi i Fletores së punës mund të fillojë që në klasë me të dhënat për shokun dhe shoqen.</p>  |  |

### Ora 7

|   |                             |   |             |
|---|-----------------------------|---|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3                              | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Grupimi i gjallesave  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Grupojmë gjetet |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.</p> <p>Krahason diëta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë.</p> |                             |   |             |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Rezultatet e të nxënës sipas temës:</b><br/>         Ndan gjallesat në grupe në bazë të disa veçorive të thjeshta dhe përshkruan logjikën e ndjekur.<br/>         Vëzhgon dhe krahason sende, gjallesa dhe dukuri.</p>  | <p><b>Fjalë kyçe:</b> grupoj, pyetje</p>   |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi, materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br/> <b>Mjete:</b> gjethe të ndryshme, rathë për qarkim, etiketa për grupet</p>   | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>         Matematikë</p>                        |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/>         Paraqitje dhe diskutim i detyrave të shtëpisë nga disa nxënës.<br/> <i>Lojë:</i> Në një rënë anë të klasës krijohet grupi i nxënësve të klasës së tretë 8 vjeç, në anën tjetër krijohet grupi i nxënësve të klasës së tretë 9 vjeç. Cili ishte tipari i përbashkët për grupet që formuam?<br/>         Me fletët e punës 3.5 a dhe 3.5 b, nxënësit do të bëjnë grupime. Organizohen nxënësit e klasës në grupe me nga 4 vetë. Pasi t'i kenë prerë etiketat me figura të fletëve të punës caktohen detyra të ndryshme për grupe të ndryshme. Secilit grup i jepet një tipar (p.sh., në bazë të mënyrës se si ushqehen, lëvizin, pamjes së tyre të jashtme, zakoneve të jetesës dhe vendeve ku jetojnë.<br/>         Secili përfaqësues i grupit prezanton punën e grupit.<br/> <i>Diskutohet</i> mbi situatën e paraqitur në libër për të dhënë nxënësit mendime rreth si mund të grupohen kafshët në figurë. Tërhiqet vëmendja në tiparet që përmend Genti (krahë, këmbë). A mund të krijohet një grup me kafshët që kanë krahë? Po me kafshët që kanë këmbë?<br/>         Kjo veprimtari përsëritet me gjetet e bimëve. Nxënësit do të gjejnë një tipar të përbashkët të tyre dhe t'i grupojnë.<br/>         Pyeten nxënësit: Çfarë kanë të përbashkët gjetet e një grupi? Si mund t'i grupojnë ndryshe ato?<br/> <i>Diskutohen</i> së bashku pyetjet: Pse shkencëtarët i grupojnë gjallesat? A mund të jenë në të njëjtin grup qeni dhe macja? Pse? Cilat kafshë dhe bimë rriten pranë vendbanimit tuaj?</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> A janë nxënësit në gjendje t'u shpjegojnë shokëve të tyre mënyrën se si kanë vepruar?<br/>         Nxënësit mund të vlerësojnë veten, duke kërkuar mënyra të tjera për të grupuar gjetet, për të cilat mendojnë se mund të kishin qenë më të suksesshme se ajo që përdorën.</p>  |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 23 Fletore Pune</p>  | <p><b>Refleksion:</b> Cili prej grupimeve t'u duk më i thjeshtë? Po më i vështirë?</p> |
| <p><b>Shënim:</b> Kjo orë mund të vazhdojë në natyrë ku nxënësit të mbledhin gjethe dhe t'i grupojnë ato. Në rast pamundësie për të nxjerrë jashtë nxënësit, atëherë për grupimet e gjetheve mund të përdoren gjethe që i kanë sjellë nxënësit më parë.</p>   |  |

Ora 8

| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3  | <b>Data</b>     |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|-----------------------------|---|-----------------|--|----|----|-----|--|--|------|--|--|-----|--|--|------|--|--|----------|--|--|--------|--|--|----|--|--|------|--|--|-----------|--|--|------|--|--|---|--|----------------|----------|----------|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 1)  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.<br>Krahason dieta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë.<br>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.<br>Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara.<br>Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.   |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> marr frymë, të vegjël, rritem, nxjerr, procese jetësore, grupoj    |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjetet:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra   |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Kimi Biologji), Art (Art pamor) Matematikë |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br>Lojë: Në disa fleta të kthyer mbrapsht janë shkruar fjalë. Nxënësit do të vijnë me radhë lexojnë fjalën dhe njëri prej nxënësve në klasë do të japë shpjegimin e fjalës së shkruar dhe krahasuar me shpjegimin e dhënë. (do të përdoren fjalët në fq. 24 të Fletores së punës.)<br><i>Punë e pavarur:</i> Ftohen nxënësit të punojnë individualisht fq. 40-41 të librit.<br>Nxënësit të organizuar në dyshe do të ndërtojnë nga një poster ku të përshkruajnë një mjedis të caktuar, si për shembull një pyll, park, shkretëtirë, bregdet etj. Më pas nxënësit duhet të bëjnë një listë me emrat e gjallesave që gjenden në këto mjedise dhe t'i shkruajnë ato në letra me ngjitje. Këto të dhëna do t'i organizojnë në tabelë. Nxënësit mund të grupojnë gjallesat në tabela dhe me tipare të tjera të përbashkëta. |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Emri</th> <th colspan="2">A është kafshë?</th> </tr> <tr> <th>Po</th> <th>Jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>zog</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>bimë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>uji</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>pemë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>bretkosë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>flutur</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>mi</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>bimë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>lulëzuese</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>etj.</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>  |                             | Emri  | A është kafshë? |  | Po | Jo | zog |  |  | bimë |  |  | uji |  |  | pemë |  |  | bretkosë |  |  | flutur |  |  | mi |  |  | bimë |  |  | lulëzuese |  |  | etj. |  |  | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emri i kafshës</th> <th>Me këmbë</th> <th>Pa këmbë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> |  | Emri i kafshës | Me këmbë | Pa këmbë |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| Emri   | A është kafshë?             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  | Po                          | Jo  |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| zog  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| bimë   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| uji  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| pemë   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| bretkosë   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| flutur   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| mi   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| bimë   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| lulëzuese  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| etj.   |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| Emri i kafshës   | Me këmbë                    | Pa këmbë  |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <i>Ekspozim i punimeve:</i> Nxënësit mund t'i vlerësojnë punimet bashkërisht duke i krahasuar, duke shtuar gjëra të reja, apo duke propozuar ide për t'i përmirësuar ato.  |                             |   |                 |  |    |    |     |  |  |      |  |  |     |  |  |      |  |  |          |  |  |        |  |  |    |  |  |      |  |  |           |  |  |      |  |  |   |  |                |          |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |

|  |  |
|--|--|
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre. |  |
| <b>Detyra:</b> Punimi i Fleta e punës 3.6 a, b   | <b>Refleksion:</b> A jeni të kënaqur me modelet që krijuat? Çfarë mund rregulloni? |
| <b>Shënim:</b>   |  |

## Ora 9

|  |                             |  |             |
|--|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 2)<br>Detyrë përmbledhëse/Test  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.<br>Krahason dieta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë.<br>Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin etj.<br>Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje. |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimave dhe veprimtarive të punuara.   |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> marr frymë, të vegjël, rritem, skelet, muskuj, nxjerr, procese jetësore, grupoj |             |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjete:</b> fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra   |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Kimi Biologji) Art (Art pamor)                          |             |
| <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br>Nxënësit <i>prezantojnë</i> mbresat e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë.<br><i>Punë e pavarur:</i> Plotësimi i detyrave përmbledhëse.<br>Diskutim dhe vetëvlerësim i punës së kryer.   |                             |  |             |
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për punimin e Detyrës përmbledhëse/Testit.  |                             |  |             |
| <b>Shënim:</b> Kjo orë mund të shfrytëzohet si testim ose si detyrë përmbledhëse e tremujorit të dytë.   |                             |  |             |



## Kapitulli 4: Materialet

### Ora 1

|   |                             |   |             |
|---|-----------------------------|---|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>  | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Vetitë e materialeve  |                             | <b>Situata e të nxënët:</b> Çfarë materiali është?  |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b><br/> Vëzhgon dhe përshkruan lëndët në bazë të vetive të tyre si: fortësia, butësia, ashpërsia, shkëlqimi metalik.<br/> Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.</p>   |                             |   |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b><br/> Mëson se çdo lëndë ka veti të caktuara, si p.sh., i fortë, i butë, me shkëlqim etj.<br/> Bën përgjithësime dhe vëren modelet e ngjashme te rezultatet.</p>   |                             | <p><b>Fjalë kyçe:</b> veti, i përkulshëm, i fortë, i papërshkueshëm nga uji, përthithës</p> |             |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi<br/> <b>Mjetet:</b> materiale të ndryshme</p>  |                             | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/> Shkencat (Fizikë)</p>                              |             |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Ftohen nxënësit të shohin objekte në klasë (të përbëra prej një lënde). Drejtohen pyetje; Çfarë është? Përmendi një send dhe thoni nga çfarë lënde është i përbërë ai.<br/> <i>Vrojtim:</i> Kur nxënësit të gjejnë emrin e lëndës që përbën një send, nxiten nxënësit të arsyetojnë mbi të.<br/> Ata mund të përmendin pamjen e tij, p.sh., i shndritshëm, i zbehtë, ngjyra që ka: ndjesia kur e prek, p.sh., i ashpër, i butë, i ftohtë, me gunga: ose të qenit i punueshëm, i sertë, i butë, i përkulshëm, i fortë, i ngurtë. Ju shpjegohet nxënësve se të gjitha këto, përbëjnë ato që ne e i quajmë veti të diçkaje.<br/> Nxënësit në dyshe studiojnë sende të tjera dhe të dhënat i shkruajnë në tabelën e fletës së punës 4.1a.<br/> Nxënësve me nivelin e arritjeve më të ulëta, u kërkohet të flasin për një lëndë në sende të njohura si një pirun, një shall, një libër që e kanë rastisur diku. A arrijnë ata të bëjnë dallimin midis sendit dhe lëndës prej së cilës ai përbëhet?<br/> <i>Lojë:</i> Vendosen disa sende të ndryshme në një çantë ose në një kuti. Nxënësit duhet të futin dorën brenda, t'i prekin dhe t'u përshkruajnë karakteristikat e tyre nxënësve të tjerë, të cilët duhet të përipiqen të gjejnë se për çfarë sendi bëhet fjalë. (Kjo lojë mund të zhvillohet në dyshe ose në grup).</p> |                             |   |             |

*Bisedë* me nxënësit rreth figurës së librit me astronautin. Drejtohet pyetja: Çfarë materialesh do të përdornit për të bërë një kostum astronauti? Diskutoni me nxënësit për vetitë që duhet të ketë një kostum hapësinor. Ai duhet të jetë në gjendje të mbajë brenda ajrin pa e lejuar që të rrjedhë, duhet të jetë elastik, por edhe i fortë njëkohësisht, në mënyrë që të mos dëmtohet. Kostumet hapësinore zakonisht bëhen prej pëlthurash të bardha ose të shndritshme, që të reflektojnë dritën e diellit. Nëse nxënësit shtrojnë idenë e përdorimit të fletëve metalike, pyeten ata nëse mendojnë se ky material është i fortë sa duhet. Çfarë do të ndodhte nëse një astronaut do të rrëzohej në Hënë? Një zgjidhje e mirë do të ishte kombinimi i disa lëndëve, fletë metalike për të mos lejuar ajrin të dalë jashtë kostumit dhe një shtresë e jashtme e trashë, por elastike, prej pambuku.

**Vlerësimi:** Përdorni veprimtaritë e mëparshme për të kuptuar se çfarë dinë nxënësit për lëndët. A arrijnë ata të bëjnë dallimin midis sendit dhe lëndës prej së cilës ai përbëhet? Çfarë fjalësh përdorin ata? A përmendin ata grupet e lëndëve, si druri apo plastika?

**Detyra:** Punimi i detyrës së fq. 25 të Fletores së Punës.

- Të krijojnë “Librarinë e lëndëve” fleta e punës 4.1b.

- **Refleksion:** A ishte e vështirë të arrije në përfundime?

**Shënim:** Loja mund të zhvillohet ndryshe edhe në këtë mënyrë: Njëri nga nxënësit do t'i mbulojë sytë me shami dhe do të përshkruajë sendin, ndërkohë që nxënësit e tjerë mund ta shohin atë. Nxënësi me sy mbyllur do ta përshkruajë sendin vetëm duke e prekur dhe më pas do të përpiqet të gjejë se për çfarë sendi bëhet fjalë. Të tjerët mund ta ndihmojnë duke përshkruar sendin ose duke i dhënë atij ndonjë detaj ndihmës.

Për krijimin e “Librarisë së lëndëve” mund të ndihmojë mënyra e organizimit të fletës së punës 4.1b. Nxënësit mund edhe t'i fotografojnë materialet.

Kjo orë mësimi mund të zhvillohet dhe jashtë.

## Ora 2

| Fusha: Shkencë  | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
|---|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Grupimi i materialeve sipas vetive të tyre  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Të klasifikojmë materialet                |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Vëzhgon dhe përshkruan lëndët në bazë të vetive të tyre si: fortësia, butësia, ashpërsia, shkëlqimi metalik.<br>Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br>Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br>Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre. |                      |   |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Mëson se çdo lëndë ka veti të caktuara (e fortë, e butë, e shndritshme).<br>Ndan lëndët në bazë të vetive që ato kanë.<br>Bën përgjithësime dhe vëren modelet e thjeshta të rezultatet.   |                      | <b>Fjalë kyçe:</b> i fortë, i butë, pa shkëlqim, me shkëlqim          |      |
| <b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br><b>Mjete:</b> objekte të ndryshme që përbëhen vetëm nga një material.  |                      | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Biologji), Art, Teknologji |      |

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim</i> i detyrave të shtëpisë. Pyeten nxënësit nëse mund të gjejnë sende të tjera që përbëhen nga i njëjti material? Cilat mund të jenë ato? Çfarë vetish mund të thoni për to?</p> <p>Sqarohen nxënësit se ekzistojnë llojet të panumërta të lëndëve në botën. Ata do të kërkojnë dhe analizojnë disa prej tyre. Shihen dhe komentohen situatat e paraqitura në faqen 44 të librit.</p> <p><i>Kërkim:</i> Të organizuar në dyshe nxënësit do të ndajnë lëndët në grupe, duke u bazuar në vetitë e tyre. Secila dyshe ka objektet të cilat do të vëzhgojë. Ndërtojnë një librari lëndësh në trajtën e pemës së degëzuar. Përzgjidhen dy lëndë dhe shtrohet një pyetje, së cilës t’i përgjigjen me ‘po’ për njërin nga lëndët dhe ‘jo’ për tjetrën. P.sh., A është metal? Në vazhdim zgjidhet një lëndë tjetër dhe shtrohet e njëjta pyetje. Pas ndërtimit të këtij degëzimi kërkohet që nxënësit të shtojnë një tjetër pyetje që do t’i ndante këto lëndë me një ‘po’ ose ‘jo’ të thjeshtë. Gjatë ndarjes në grupe nxënësit do të bazohen në vetitë e mëposhtme: i qëndrueshëm/jo i qëndrueshëm, i shndritshëm/i zbehtë, elastik/joelastik, i ngurtë/i butë dhe i fuqishëm/i dobët. Diskutohen përfundimet e kërkimeve.</p> <p>Nxënësve me nivelin e arritjeve të larta ju kërkohet t’i radhisin lëndët nga më e forta te më e buta ose nga më e ashpra te më e lëmuara.</p> <p>Gjithashtu ftohen nxënësit të diskutojnë për pyetjet e dhëna në libër: Cilat janë tri materiale të ndryshme që nuk janë të përshkueshme nga uji? Tregoni të gjitha vetitë që mendoni se i ka materiali plastik.</p> <p><i>Imagjinatë e drejtuar:</i> Kërkoni nga nxënësit të përdorin për një çast imagjinatën. Të imagjinojnë diçka që duhet të jetë e lehtë dhe e rezistueshme njëkohësisht. Ekzistojnë shumë sende, të cilat lëvizin ose që mund të merren me vete, që i zotërojnë këto dy veti, për shembull biçikleta, aeroplani, balona, makina, telefoni ose lap-topi. Po ide të tjera?</p> |   |
| <p><b>Vlerësimi:</b> A janë në gjendje të argumentojnë zgjedhjet e tyre në klasifikimin e lëndëve? A marrin pjesë nëpërmjet komenteve në lidhje me zgjedhjet e grupeve të tjera?</p>   |   |
| <p>Detyra: Punimi i detyrës së fq 26 të Fletores së Punës.<br/>Fleta e punës 4.2</p>   | <p><b>Refleksion:</b> Nëse do të krijoje një objekt, çfarë objekti do të ishte? Çfarë vetish do të kishte lënda me të cilën do të përbëhej?</p> |
| <p><b>Shënim:</b> Në faqen <a href="http://www.crickweb.co.uk/ks1science.html">http://www.crickweb.co.uk/ks1science.html</a> (Materiale 2) kërkon prej nxënësve të ndajnë lëndët, duke pasur parasysh nëse ato janë natyrale ose artificiale.</p>  |   |

### Ora 3

| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
|--|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Përdorimet e materialeve   |                      | <b>Situata e të nxënët:</b> Gjetje inteligjente dhe gjetje pa kuptim. |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Vëzhgon dhe përshkruan lëndët në bazë të vetive të tyre si: fortësia, butësia, ashpërsia, shkëlqimi metalik.</p> <p>Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.</p> <p>Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.</p> <p>Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.</p> <p>Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.</p> |                      |   |      |

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Rezultatet e të nxënës sipas temës:</b><br/>Mëson se çdo lëndë ka veti të caktuara (e fortë, e lëmuar, e shndritshme).<br/>Diskuton pse disa lëndë përdoren për qëllime të caktuara, duke u bazuar te vetitë e tyre.</p>   | <p><b>Fjalë kyçe:</b> vrojtim</p>  |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br/><b>Mjetet:</b> disa objekte në klasë të cilat përbëhen nga një material i vetëm</p>   | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Shkencat (Biologji), Art, Teknologji</p>                     |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/><i>Ditari trepjesësh:</i> Ju tregohen nxënësve sende të përditshme si lodra, enë gatimi ose pajisje laboratorike. Nxiten ata të bëjnë dallimin midis emrit të sendit dhe emrit të lëndës ose lëndëve prej të cilave ai përbëhet.<br/>Shkruhen në tabelë sipas rubrikave: emri i sendit; materiali; vetitë e tij.<br/>Drejtohet pyetja: Pse objektet përbëhen nga materiale të ndryshme?<br/><i>Veprimtari:</i> Zhvillohet në grup veprimtaria 4.3 në libër. Tërhiqet vëmendja në diskutimin pse disa lëndë të caktuara janë të përshtatshme për sende të caktuara. Nxënësit mund të mbajnë shënime në grup dhe individualisht të përdorin fletën e punës 4.3a.<br/>Ftohen nxënësit të diskutojnë rreth: A mund të përdorim një makinë prej akulli? Pse? A ju duket kjo një gjetje inteligjente apo pa kuptim? A mundet të zbuloni arsyet? Do të ishte e pamundur të ndërtonim një makinë prej akulli, sepse pjesët do të ngrini të gjitha së bashku, ose e gjithë makina do të shkrinte. Gjithashtu, ajo do të ishte dhe shumë e ftohtë për t'u ulur dhe rrotat e saj do të rrëshqisnin mbi asfalt. Sugjeroni sende të tjera prej lëndësh pa kuptim.<br/><i>Lojë:</i> "Inteligjente apo pa kuptim". Përmendin një emër sendi dhe kërkohet prej tyre të gjejnë një lëndë<br/>«pa kuptim» për atë send dhe të shpjegojnë pse ajo është e tillë. Pas kësaj, ata duhet të përmendin një lëndë tjetër «inteligjente» dhe të arsyetojnë mbi të. Për shembull, një dritare e bërë me biskota do të ishte një zgjidhje pa kuptim, sepse biskota nuk është e tejdukshme, ndërsa xhami do të ishte zgjidhje inteligjente sepse ai është i tejdukshëm. Kështu nxënësit do të vazhdojnë në dyshe fletët e aktivitetit 4.3b dhe c.<br/>Diskutohet me nxënësit mbi përdorimin e qeseve plastike. Pse plastika e hollë është e përshtatshme për qeset e supermarketeve? Cilat janë dizantavantazet që ato kanë? Pa mendoni se sa të tilla ndodhen në pikat e grumbullimit të plehrave? Çfarë do të ndodhte nëse në vend të qeseve plastike do të përdornim çantat e letrës?<br/><i>Lexim i drejtuar</i> i përrallës "Tre derrkucët" (version i shkurtuar) Cila është lënda më e përshtatshme për të ndërtuar një shtëpi? Pse?</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Si argumenton faktin se pse disa lëndë përdoren për qëllime të caktuara, duke u bazuar te vetitë e tyre.</p>  |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq 27 Fletore Pune<br/>Me dëshirë nxënësit mund të bëjnë një listë të lëndëve që gjenden në oborrin e shkollës dhe për se përdoren ato.</p>   | <p><b>Refleksion:</b> Po ti në botën e ëndrrave prej çfarë lënde do ta doje shtëpinë tënde? Pse?</p> |

**Shënim:** Nxënësit mund të shtojnë informacione të tjera për përdorimin e lëndëve në *Librarinë e tyre të Lëndëve*  
 Nxënësve mund t'u pëlqejë videoja që gjendet në faqen: [http://www.tellyads.com/show\\_movie.php?fi\\_lename=TA3525](http://www.tellyads.com/show_movie.php?fi_lename=TA3525), e cila bën fjalë për një makinë prej çokollate.  
 Në faqen: <http://www.statisticbrain.com/plasticbag-statistics/> mund të gjeni informacion dhe shtesë mbipërdorimin e qeseve plastike.  
 Tregimin 'Tre derrkucët' në faqen: <http://homepages.unipaderborn.de/odenbach/wwwmath/pigs/pigs.html> ose:  
[http://www.literactive.com/Download/live.asp?swf=story\\_fi\\_les/three\\_little\\_pigs\\_US.swf](http://www.literactive.com/Download/live.asp?swf=story_fi_les/three_little_pigs_US.swf).

#### Ora 4

| Fusha: Shkencë  | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3  | Data |
|---|----------------------|--|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Provojmë materiale të ndryshme  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Cili material është më i mirë? |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Mëson se çdo lëndë ka veti të caktuara (e fortë, e lëmuar, e shndritshme).<br>Diskuton pse disa lëndë përdoren për qëllime të caktuara, duke u bazuar te vetitë e tyre.  |                      |  |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Mëson se çdo lëndë ka veti të caktuara (e fortë, e butë, me shkëlqim);<br>Diskuton arsyet pse lëndët përzgjidhen në bazë të vetive për një qëllim të caktuar.<br>Mbledh prova të ndryshme për t'u përgjigjur pyetjeve dhe për të vërtetuar hipoteza.  |                      | <b>Fjalë kyçe:</b> vrojtim, provë                          |      |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjetet:</b> copa pëlhurash të ndryshme, letër, fletë metalike, hinkë e vogël, cilindër, matës, kohëmatës, fletë letre të holla, të llojeve të ndryshme, gurë peshe, qese plastike e fortë.  |                      | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br>Art, Teknologji        |      |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br><i>Prezantim i situatës:</i> Kur jemi nën çadër, nuk lagemi nga shiu. Kjo do të thotë që materiali i saj është i papërshkueshëm nga uji. A njihni ndonjë material të tillë, që nuk e lejon ujin të kalojë përmes tij?<br>Hetimi 1: Udhëzohen nxënësit se do të kryejnë një hetim për të gjetur cila prej llojeve të ndryshme të pëlhurave që kanë është më e përshtatshme për çadër. Diskutohet se çfarë duhet për të kryer një hetim të drejtë; sasia e ujit që do të përdoret në të gjitha provat do të jetë e njëjtë; mostrat e materialeve që do të përdoren, duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha sa të mbulojnë anët e hinkës. Kjo do të parandalonte që uji të kalojë nga hapësirat e mbetura bosh të hinkës te cilindri matës.<br>Nxënësit me nivel të lartë të arritjeve nxiten nëpërmjet pyetjeve ku ata të bazohen gjatë hulumtimeve të tyre.<br>Cila është çështja? Cili është parashikimi ynë? Çfarë duhet të ndryshojmë? Çfarë do të matim?<br>Nxënësit mund t'i përzgjedhin vetë pajisjet që do të përdorin. Për të shënuar rezultatet, nxënësit mund të ndërtojnë secili nga një tabelë, ose të përdorin fletën e punës 4.4 a. |                      |  |      |

|  |  |
|--|--|
| <p>Nxënësit do të vëzhgojnë me vëmendje materialet. Për këtë mund të përdorin një xham zmadhues.</p> <p>Nxiten të japin mendime pse disa lëndë janë kundra ujit dhe disa të tjera jo?</p> <p>Disa pëlhura kanë vrima të vogla që e lejojnë ujin të kalojë Nga këto, pjesa më e madhe e përthith atë. Materialet kundra ujit nuk kanë vrima dhe nuk e thithin atë, kjo është lënda më e përshtatshme nga të tjerat për çadër.</p> <p>Hetimi 2: Që ky eksperiment të jetë i drejtë, nxënësit duhet të kenë parasysh që për secilin rast të përdorin shirita letre me gjerësi të barabartë. Për të shënuar rezultatet nxënësit mund të ndërtojnë një tabelë sipas idesë së tyre, ose mund të përdorin si model tabelën e paraqitur në Fletën e punës 4.4b.</p> <p>Nxënësit do të vëzhgojnë nga afër (me ndihmën e zmadhuesit) letrat më të forta dhe ato më të dobëtat.</p> <p>Përse disa lloje letrash janë më të forta se disa të tjera? Zakonisht, letrat më të trasha janë më të qëndrueshme se ato të hollat.</p> <p><i>Përfundime:</i> Pas diskutimit brenda grupeve dhe formulimit të përfundimeve, përfaqësues të grupeve përshkruajnë hetimin dhe prezantojnë përfundimet e grupit të tyre.</p> <p>Drejtohen pyetjet: Çfarë mund të bënit më mirë gjatë hetimit tuaj? Si do të vepronit për të gjetur se cila pecetë letre e thith ujin më mirë? Nxënësit japin mendime. Udhëzohen se si mund të veprojnë dhe se këtë provë mund ta bëjnë në shtëpi.</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfshirjen gjatë hetimit. Mendimet që japin gjatë diskutimit në grup, mënyrën e mbledhjes së provave dhe qëndrimet e tyre në lidhje me përfundimet.</p>   |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 28 Fletore Pune</p>   | <p><b>Refleksion:</b> Si u ndjetë me provat e hetimit?</p> |
| <p><b>Shënim:</b></p>  |  |

## Ora 5

|   |                             |  |             |
|---|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Materialet magnetike  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Cilat materiale janë magnetike?    |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <p>Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.</p> <p>Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.</p> <p>Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.</p> <p>Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.</p> <p>Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.</p> |                             |  |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <p>Zbulon se disa lëndë kanë veti magnetike, ndërsa shumë të tjera jo</p> <p>Ndan lëndët në bazë të vetive që ato kanë.</p> <p>Mbledh prova të llojeve të ndryshme, për t'u përgjigjur pyetjeve dhe vërtetuar hipoteza.</p> <p>Bën përgjithësime dhe të zbulon modelet e thjeshta të rezultatet.</p>  |                             | <p><b>Fjalë kyçe:</b> magnet, tërheq, magnetik, jomagnetik</p> |             |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi<br/> <b>Mjetet:</b> magnet, disa materiale për provë</p>   | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>                 Shkencat (Fizikë)</p> |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Keni parë ndonjëherë magnetë? Ku i keni parë? Përse përdorëshin?<br/>                 Plotësohen nxënësit me informacionin se magnetet përdoren zakonisht për të varur shënime mbi frigoriferë ose tabela lajmërimesh, ose si elemente dekorative. Magnetet përdoren te lodrat, madje shpesh ato përdoren si bashkues për trenat lodër – kjo është një mënyrë e mirë për të ilustruar shtytjen magnetike. Magnetet shtytës mund të shërbejnë për të ngritur sendet në ajër - kjo është një mënyrë e mirë për të zvogëluar fërkimin. Madje kjo metodë përdoret edhe te trenat më të shpejtë në botë, të njohur si trenat e Maglevit.<br/>                 Njihen nxënësit me problemin e Gentit të cilit magneti nuk i qëndroi në kanatën prej druri të dollapit ndërsa në kanatin e frigoriferit po. Diskutohet me nxënësit nëse u ka ndodhur dhe atyre një situatë e ngjashme? Si mendoni ju pse ndodh?<br/> <i>Prezantohet pohimi:</i> Disa materiale tërhiqen nga magnetet. Këto materiale quhen materiale magnetike. Materialet që nuk tërhiqen nga magnetet janë jomagnetike. Ftohen nxënësit të hetojnë llojet e materialeve nëse janë magnetike ose jo.<br/> <i>Hetim:</i> Nxënësit në dyshe kanë magnetë dhe objekte me materiale të ndryshme. Fillimisht do të diskutojnë me njëri tjetrin rreth parashikimeve të tyre nëse materiali i objektit është magnetik apo jo. Për tëhedhur të dhënat nxënësit do të përdorin fletën e punës 4.5 a ose vizatojnë një tabelë të ngjashme me atë të librit në fq. 51.<br/>                 Pas përfundimit të hetimit dhe hedhjes së të dhënave në tabelë studiohen ato për të dalë në përfundim.<br/>                 Përfundimet e hetimit: Për të formuluar përfundimet nxënësit orientohen nëpërmjet pyetjeve: A shihni ndonjë lidhje midis tyre? A ka materiale që nuk tërhiqen asnjëherë nga magnetet? Cilat materiale janë magnetike?<br/>                 Në përfundim nxënësit plotësojnë individualisht Fletën e punës 4.5 b.</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfshirjen dhe përdorimin e fjalëve të fjalorit në përputhje me magnetet dhe lëndët magnetike ose jomagnetike. Për pjesëmarrjen në hetim dhe mendimet rreth përfundimeve.<br/>                 Vlerësohen individualisht nëpërmjet punimit të Fletës së punës 4.5 b</p>  |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 29 Fletore Pune<br/>                 Me dëshirë nxënësit nëse kanë magnet në shtëpi mund të testojnë sende të ndryshme, për të parë nëse janë ose jo magnetike. Ata mund t'i paraqesin sendet në një listë ose t'i vizatojnë dhe më pas t'i emërtojnë ato.</p>   | <p>Refleksion: Për çfarë tjetër mund t'i përdorim magnetet?</p>                |
| <p><b>Shënim:</b></p>   |  |

## Ora 6

|  |                             |   |             |
|--|-----------------------------|---|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>  | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...   |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/>         Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br/>         Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br/>         Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.<br/>         Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.<br/>         Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.</p>  |                             |   |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/>         Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara.<br/>         Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.</p>  |                             | <p><b>Fjalë kyçe:</b> i fortë, i butë, pa shkëlqim, me shkëlqim, magnet, tërheq, magnetik, jomagnetik</p> |             |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi<br/> <b>Mjetet:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra</p>  |                             | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>         Shkencat (Kimi Biologji) Art (Art pamor) Matematikë</p>  |             |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> <i>Dy të vërteta një e gabuar:</i> Nxënësit shkruajnë në një fletë dy pohime të vërteta dhe një të gënjeshtërt në lidhje me çfarë ka mësuar për materialet. Të organizuar në grupe ata do të këmbëjnë fletët me njëri-tjetrin dhe do të gjejnë cilat janë pohimet e vërteta dhe cilat jo. Pas përcaktimeve me radhë të gjithë pjesëtarët e grupit do të lexojnë pohimet e shkruara nga shoku dhe do të tregojnë zgjedhjet e tyre (të vërteta ose jo).<br/> <i>Punë e pavarur:</i> Ftohen nxënësit të punojnë individualisht fq. 52-53 të librit.<br/>         Në fund diskutohen së bashku përfundimet e ushtrimit 1 dhe 4.</p> |                             |   |             |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për formulimin dhe gjetjen e saktë të pohimeve.</p>   |                             |   |             |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 30 Fletore Pune</p>   |                             | <p><b>Refleksion:</b> Keni ndonjë material tuajin të preferuar? Pse?</p>                                  |             |
| <p><b>Shënim:</b></p>  |                             |   |             |

## Ora 7

|   |                             |  |             |
|---|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>                         | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Projekt (ora 1)<br>Krijojmë një lodër   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Lodra jonë |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/>         Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br/>         Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br/>         Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.<br/>         Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.<br/>         Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.</p> |                             |  |             |



|  |   |
|--|---|
| <p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b><br/>Krijon duke përdorur njohuritë e tij në lidhje me materialet dhe vetitë e tyre.</p>  | <p><b>Fjalë kyçe:</b> lodër, krijoj, ndërtoj, formoj, veti</p>        |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi<br/><b>Mjetet:</b> materiale të ndryshme, fleta, lapsa, ngjyra</p>  | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Teknologji, Art, Qytetari</p> |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/>Diskutim: Cila është lodra juaj e preferuar? Pse? Nga se përbëhet ajo?<br/>Disa nga lodrat dhe materialet me të cilat është e ndërtuar ajo, shkruhen në tabelë.<br/>Si mendoni ju pse është/janë zgjedhur pikërisht këto materiale për të ndërtuar këtë lodër?<br/>Nëse do të krijonit ju një lodër si duhet të ishte ajo? Me çfarë materiale mund të përdorëshin?<br/>Prezantim i projektit: Qëllimi i këtij projekti është që ju (vetë nxënësit) të krijoni dhe ndërtoni një lodër me të cilën mund të luhet. Se sa e suksesshme do të jetë kjo lodër do të duket nëse do të arrini ta shisni atë në “Panairin e lodrave”.<br/>Hapi 1: Në grupe do të diskutojnë rreth ideve në lidhje me lodrën interesante. Secili do t’i prezantojë grupit idenë e tij. Do të veçohet ideja më tërheqëse dhe e realizueshme nga vetë ata.<br/>Hapi 2: Analizë e pjesëve përbërëse dhe si do të funksionojnë ato. Përcaktimi i llojit të materialeve me të cilat do të punohet dhe kombinimi i vetive të tyre me funksionimin sa më të mirë. Që në këtë fazë mund të emërtohet lodra dhe krijohet një prezantim interesant për të (reklamë) si dhe një çmim shitje. Ky prezantim do të shërbejë për të tërhequr vëmendjen e pjesëmarrësve në panair.<br/>Hapi 3: Ndahen detyrat ndërmjet pjesëtarëve të grupit.<br/>Udhëzohen nxënësit se puna për ndërtimin e lodrës mund të vazhdojë dhe në shtëpi.<br/>Hapi 4: Secili grup diskuton mbi ecurinë dhe vështirësitë e projektit. Si mund të veprohet për t’i kaluar ato.<br/>Hapi 5: Organizimi i panairit dhe ftesa ndaj nxënësve të tjerë të shkollës.<br/>Hapi 6: Zhvillimi i panairit. Secili grup ka hapësirën e tij për të prezantuar lodrën e ndërtuar prej tyre. Gjatë panairit, nxënësit do të mundohen ta bëjnë sa më interesant prezantimin dhe të mundësojnë shitjen e lodrës së tyre.</p> |   |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për kreativitetin, bashkëpunimin, kontributin e tyre në realizimin e projektit të përbashkët.</p>   |   |
| <p><b>Detyra:</b> Përgatitja sipas detyrave të caktuara në grup.</p>   | <p><b>Refleksion:</b></p>   |
| <p><b>Shënim:</b> - Kujdes në sqarimin e nxënësve se ata duhet të krijojnë një lodër të thjeshtë me të cilën mund të luhet.<br/>- Theksohet se puna me lodrën do të jetë vetëm e nxënësve.<br/>- Projekti do të shtrihet në 2 orë mësimore të Diturisë së Natyrës dhe nëse është e nevojshme me orë të Kurrikulës me Zgjedhje (hapi 4 dhe 5).<br/>- Projekti mund të finalizohet dhe vetëm me prezantimin në panair, pa përfshirë në të shitjen e lodrës.</p>  |   |

## Kapitulli 5: Forcat dhe lëvizja

### Ora 1

|   |                             |   |             |
|---|-----------------------------|---|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3  | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Shtytja dhe tërheqja  |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Si ndikojnë forcat tek objektet?                                    |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/> Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br/> Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/> Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/> Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.<br/> Tregon kuriozitet për mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/> Tregon kuriozitet për shkaqet e ndryshimit të lëvizjes së trupave kur mbi ta veprojnë forca.</p>  |                             |   |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/> Studion se si forcat i bëjnë sendet të lëvizin ose të ndalojnë.<br/> Ngre hipoteza, bën parashikime dhe i shpalos ato.<br/> Kryen matje, duke përdorur pajisje të thjeshta dhe i paraqet rezultatet në disa mënyra.</p>  |                             | <p><b>Fjalë kyçe:</b> shtyj, tërheq, forcë, vë në lëvizje, përshpejtoj, ngadalësoj, drejtim</p> |             |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi</p> <p><b>Mjete:</b> një top, një shishe me pak ujë, karrocë, laps</p>   |                             | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/> Edukim Fizik, Art, Teknologji</p>                      |             |
| <p><b>Diskutim: Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> Disa nxënës ftohen të kryejnë para klasës disa veprime: hap – mbyll kanatën e dollapit të klasës, hap – mbyll derën e klasës, fshin me fshirëse tabelën, mpreh lapsin etj. Gjatë demonstrimit të veprimeve drejtohen pyetjet: kur e hap derën e shtyn apo e tërheq atë? Po në të njëjtën formë përcaktohet lloji i forcës që ushtrohet për të gjitha veprimet që kryejnë nxënësit. Sqarohen nxënësit se shtytja dhe tërheqja janë forca.<br/> Prezantohet nga fleta e punës 5.1a problemi i Luisit dhe ftohen nxënësit ta ndihmojnë atë, duke i treguar se cilat objekte shtyn dhe cilat tërheq ai në dhomën e tij. Nxënësit do t'i diskutojnë zgjedhjet e tyre në dyshe, duke i shpjeguar njëri-tjetrit drejtimin e lëvizjes dhe llojin e forcës. Më pas diskutohet me gjithë klasën.<br/> Bisedë me nxënësit rreth figurës dhe informacionin që jepet në fq. 54 të librit.<br/> <i>Veprimtari:</i> me mjetet e tyre të shkollës, nxënësit ftohen të vizatojnë me laps në fletë, të fshijnë me gomë, të ngjyrosin etj. Gjatë këtyre veprimtarive i tregojnë njëri-tjetrit se çfarë lloj lëvizje kryen dhe forcën që përdorën shtytëse apo tërheqëse. A përdoret forcë për të ndalur lëvizjen? A mund të ndërrojë drejtim forca?<br/> Demonstrohet situata me magnetin dhe gozhdët e vogla. Çfarë ndodhi? Çfarë force u përdor? Kush e përdori?<br/> Plotësohet posteri me fjalët e reja. Diskutohet me gjithë klasën rreth kuptimit të tyre.<br/> <i>Punë e pavarur:</i> nxënësit individualisht do të plotësojnë fletën e punës 5.1 b.<br/> Në varësi të kohës zgjedhjet dhe argumentet ia tregojnë njëri-tjetrit.</p> |                             |   |             |
| <p><b>Vlerësimi:</b> analizohen përgjigjet e nxënësve, për të kuptuar se sa njohuri kanë ata për forcat shtytëse dhe tërheqëse. A mendojnë ata se shtytja dhe tërheqja janë shembuj forcash? A mund të përshkruajnë se si forcat mund të ndalin ose të ndryshojnë drejtimin e një sendi?</p>  |                             |   |             |

|   |  |
|---|--|
| <b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 31 të Fletores së Punës.   | <b>Refleksion:</b> Nxënësit diskutojnë për gjërat që mendojnë se i kanë bërë siç duhet gjatë mësimi dhe gjërat që do të donin të përmirësonin. |
| <b>Shënim:</b> Në klasë ndërtohet një poster ku të përfshihet fjalori apo gjuha e përdorur që lidhet me forcat. Kjo do t'u mundësojë nxënësve që të plotësojnë në fletën murale për çdo temë të re të kapitullit fjalët e reja. |  |

## Ora 2

|   |                             |  |             |
|---|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>                                   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Ndryshimi i formës së materialeve.  |                             | <b>Situata e të nxëniti:</b> Ndryshimi i formës. |             |
| <p>Rezultatet e të nxëniti sipas kompetencave të fushës:<br/>                 Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br/>                 Përshkruan si forcat ndryshojnë format e trupave.<br/>                 Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/>                 Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/>                 Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.<br/>                 Tregon kuriozitet për mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/>                 Tregon kuriozitet për shkaqet e ndryshimit të lëvizjes së trupave kur mbi ta veprojnë forca.<br/>                 Vlerëson me objektivitet rezultatet e provave të tij, krahasuar me ato të shokëve.</p>   |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxëniti sipas temës:</b><br>Studion se si forcat mund të ndryshojnë formën e sendeve.<br>Mbledh prova të llojeve të ndryshme për t'u përgjigjur pyetjeve dhe për të vërtetuar hipoteza.  |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> vrojtoj, ndikoj               |             |
| <b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br><b>Mjete:</b> një top plasteline, një vizore.  |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Art, Teknologji |             |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/> <i>Situatë:</i> Nxënësve u drejtohet pyetja: si do të veproni për të bërë një top plasteline?<br/>                 Nxënësit e demonstrojnë duke e punuar secilin topin e plastelinës. Ftohen disa të përshkruajnë me fjalë se si vepruan. Tërhiqet vëmendja të përdoren fjalët në përshtatje me forcat që përdoren. Më pas pyeten: Çfarë forme do të marrë pasi e shtyp? Dhe nxënësit e demonstrojnë. Prezantohen llojet e punëve që janë të paraqitura në libër dhe diskutohet rreth forcave që përdoren në aplikimin e këtyre profesioneve të ndryshme.<br/> <i>Hetimi 1:</i> Nxënësit do të provojnë se çfarë do të ndodhë me topin prej plasteline nëse e hedhin nga lartësi të ndryshme. Për secilin rast në fletën e punës 5.2a, ata do të shkruajnë ose do të bëjnë një vizatim në lidhje me parashikimin. Kryejnë në dyshe provat dhe shkruajnë në tabelë përfundimet. Diskutohet me të gjithë rreth përfundimeve të hetimit. A mund të formulojnë një përfundim vetë nxëniti?<br/> <i>Hetimi 2:</i> Nëpërmjet një tubi, nxënësit do të hedhin një top mbi sipërfaqe të ndryshme. Ju kërkohet nxënësve të ngrenë një pyetje shkencore që kërkon përgjigje. P.sh.: Si ndikon forca e një topi në rënie te sendi ose materialet mbi të cilat ai bie? Nxiten të bëjnë parashikime të cilat do të hidhen në fletën e punës 5.2 b.<br/>                 Sqarohen nxënësit me informacionin në lidhje me elementet e peizazhit si shkëmbinjtë, plazhet, lumenjtë apo malet janë të gjitha rezultat i forcave të natyrës, në një formë ose në një tjetër. Plazhet dhe shkëmbinjtë janë rezultat i erozionit të tokës nga uji. Lumenjtë janë</p> |                             |  |             |

|   |  |
|---|--|
| <p>një tjetër element ku forca e ujit ka hapur një kanal në tokë, i cili më pas është mbushur me ujë. Malet janë formuar nga përplasja e shtresave të Tokës, dhe më pas kanë marrë formë nën ndikimin e ujit dhe erës.</p> <p><i>Përfundime:</i> Ftohen nxënësit të përshkruajnë hetimin dhe përfundimet duke përdorur fjalorin e duhur shkencor. Kërkohen shpjegime të qarta mbi mënyrën se si forcat ndikojnë në formën e materialeve dhe arsyet se pse te disa materiale, ato ndikojnë më ndryshe.</p> <p>Nxënësit individualisht plotësojnë fletën e punës 5.2 c. Pas plotësimit diskutohen në dyshe.</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> A janë në gjendje të argumentojnë veprimin e forcave. Ndikimin e forcave në materiale të ndryshme.</p>   |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 32 të Fletores së Punës.</p>  | <p><b>Refleksion:</b> Nëse do të krijoje një objekt, çfarë objekti do të ishte? Si do të veproje për t'i dhënë formën që dëshiron?</p> |
| <p><b>Shënim:</b> Në faqen: <a href="http://www.bbc.co.uk/learningzone/clips/the-use-of-forceto-change-shapel/2489.html">http://www.bbc.co.uk/learningzone/clips/the-use-of-forceto-change-shapel/2489.html</a> do të gjeni disa sekuenca ku forcat përdoren për të ndryshuar formën e gjërave. Faqja: <a href="http://www.craftexpert.co.uk/VideoMakingPlatePottery.html">http://www.craftexpert.co.uk/VideoMakingPlatePottery.html</a> paraqet metodën se si prodhohet një pjatë me anë të rrotës së qeramikes, metodë e cila bazohet në përdorimin e forcës së shtytjes dhe tërheqjes.</p>                 |  |

## Ora 3

| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
|--|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Madhësia e forcës  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Sa e madhe është forca që ushtroj?                  |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/> Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br/> Përshkruan si forcat ndryshojnë formën e trupave.<br/> Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br/> Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/> Regjistron mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/> Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.<br/> Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/> Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.<br/> Tregon kuriozitet për mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/> Vlerëson me objektivitet rezultatet e provave të tij krahasuar me ato të shokëve.</p> |                      |   |      |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br/> Mëson se shtytja dhe tërheqja janë dy shembuj forcash dhe se madhësitë e tyre janë të krahasueshme.<br/> Mbledh prova të llojeve të ndryshme për t'u përgjigjur pyetjeve dhe për të vërtetuar hipoteza.<br/> Ngre hipoteza, kryen parashikime dhe i shpalos ato.</p>  |                      | <p><b>Fjalë kyçe:</b> forca</p>   |      |
| <p><b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br/> <b>Mjete:</b> një tullumbace, objekte të ndryshme</p>  |                      | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/> Shkencat (Fizikë), Art, Teknologji</p> |      |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/>                 Prezantohen nga nxënësit përfundimet e detyrave.<br/>                 Diskutohet së bashku rreth: Çfarë dini për forcat? Nxënësit japin mendime të cilat shkruhen në tabelë në formën e një organizuesi grafik.<br/>                 Hetimi 1: Prezantohet para nxënësve një makinë lodër, një lodër pak më e madhe dhe një lodër tjetër. Të tria këto lodra janë të lidhura me ɩlastikë, në mënyrë që të tërhiqen nga një nxënës. Para se të fillojë prova nxënësit nxiten të parashikojnë se për tërheqjen e cilës lodër do të duhet të ushtrohet një forcë më e madhe? Nxënësit shkruajnë në fletore parashikimet e tyre. Zhvillohet prova. Udhëzohen nxënësit të shohin gjatësinë e ɩlastikut gjatë kohës që tërhiqet lodra.<br/>                 Krahasohen përfundimet me parashikimet. Studiohet rasti i prezantuar në libër.<br/>                 Hetimi 2: nxënësit e organizuar në dyshe do të provojnë të përcaktojnë madhësinë e forcës nëpërmjet shtyrjes së objekteve të ndryshme me tullumbace. Demonstrrohet mënyra se si do të kryhet veprimi dhe përcaktohet me të gjithë nxënësit e klasës se një gjuhë të përbashkët për të përshkruar madhësinë e një shtytje: shtytje e vogël, shtytje mesatare, shtytje e madhe. Orientohen që të shohin, se si tullumbacja tregon forcën me të cilën ata shtyjnë. Fillimisht kërkohet të parashikojnë, shqyrtojnë dhe të regjistrojnë madhësinë e forcës që nevojitet për të shtyrë një numër sendesh të sigurta si libra, kuti të vogla, këpucë, topa, dosje etj. <i>Përfundimet</i> regjistrohen në fletën e aktivitetit 5.3 a.<br/>                 Diskutohen përfundimet e provave me gjithë klasën. Nxënësit japin mendime në lidhje me përgjigjet e pyetjeve në fq. 59 të librit.</p> |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> A janë në gjendje nxënësit të krahasojnë forcat? A mund të flasin për ndikimet që kanë forca të ndryshme? A mund të flasin për ekzistencën e forcave të vogla dhe forcave më të mëdha?</p>   |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 33 Fletore Pune<br/>                 Bëni një listë të gjërave në shtëpi, të cilat kërkojnë forca të vogla, mesatare dhe të mëdha për të lëvizur.</p>  | <p><b>Refleksion:</b> A mund të matet forca?</p> |
| <p><b>Shënim:</b></p>   |  |

#### Ora 4

|  |                             |   |  |
|--|-----------------------------|---|--|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa</b> 3                                | <b>Data</b>                                  |
| <b>Tema mësimore:</b> Forcëmatësi  |                             | <b>Situata e të nxënimit:</b> Matja e forcave |  |
| <p><b>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës:</b><br/>                 Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br/>                 Mat forcën me dinamometër.<br/>                 Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/>                 Regjistron mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/>                 Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.<br/>                 Vlerëson me objektivitet rezultatet e provave të tij krahasuar me ato të shokëve.</p> |                             |   |  |
| <p><b>Rezultatet e të nxënimit sipas temës:</b><br/>                 Mëson se shtytja dhe tërheqja janë dy lloje forcash dhe se ato mund të maten me anë të dinamometrit.<br/>                 Kryen matje, duke përdorur pajisje të thjeshta dhe të pasqyrojmë rezultatet në disa mënyra.</p>   |                             |   | <p><b>Fjalë kyçe:</b> forcëmatës, njuton</p> |

|   |   |
|---|---|
| <b>Burimet:</b> materiale mbështetëse për veprimtarinë.<br><b>Mjete:</b> forcëmatës   | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br>Shkencat (Fizikë), Art,<br>Teknologji |
| <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br>Prezantohen dhe diskutohen përfundimet e detyrës në lidhje me madhësinë e forcave.<br>Provë1: Një nxënës duhet të shtyjë derën e klasës, duke përdorur një copë sfungjeri. Një tjetër do të shtyjë me kujdes dhe fare lehtë një kuti me libra. Kërkohet nga ai që ta shtyjë pak më shumë, por kutia përsëri nuk do të lëvizë. Sa është shtytja e ushtruar? Propozoni një mënyrë për të matur madhësinë e forcës së ushtruar.<br>Do të zhvillohet një veprimtari e ngjashme, por kësaj radhe duke e tërhequr kutinë. Fillohet duke tërhequr fare lehtë. Përsëri forca nuk është e dukshme, prandaj nxënësit do të tërheqin, duke përdorur një llastik të fortë. Pyeten nxënësit nëse mendojnë se tullumbacja dhe llastiku ishin të dobishme.<br>A keni parë ndonjëherë një pajisje që mat forcat? Tregohet një dinamometër. Njësia matëse e forcës është njutoni (N). Ajo është emërtuar kështu në nder të shkencëtarit të njohur, Isak Njuton, i cili u mor gjatë me studimin e forcave.<br>Provë2: Me dinamometër nxënësit në grupe me radhë bëjnë matjen e forcave të ndryshme që do të ushtrojnë për të tërhequr trupa të ndryshëm. Rezultatet shënohen në fletën e punës 5.4. Diskutohen përfundimet e provave me gjithë klasën. Nxënësit japin mendime në lidhje me përgjigjet e pyetjeve në fq. 61 të librit. |   |
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfshirjen dhe përdorimin e fjalëve të fjalorit në përputhje me temën.  |   |
| <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 34 Fletore Pune   | <b>Refleksion:</b> Si u ndjetë gjatë matjeve?                             |
| <b>Shënim:</b>  |   |

## Ora 5

|  |                             |  |  |
|--|-----------------------------|--|--|
| <b>Fusha:</b> Shkencë  | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>                                 | <b>Data</b>  |
| <b>Tema mësimore:</b> Fërkimi  |                             | <b>Situata e të nxënët:</b> Forca dhe fërkimi. |  |
| <b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b><br>Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br>Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br>Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.<br>Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br>Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.<br>Regjistron mënyrën e lëvizjes së trupave.<br>Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.<br>Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.<br>Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.<br>Tregon kuriozitet për mënyrën e lëvizjes së trupave.<br>Tregon kuriozitet për shkaqet e ndryshimit të lëvizjes së trupave kur mbi ta veprojnë forca.<br>Vlerëson me objektivitet rezultatet e provave të tij, krahasuar me ato të shokëve. |                             |  |  |
| <b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b><br>Zbulon se si disa forca, përfshirë edhe fërkimin, përshpejtojnë, ngadalësojnë ose ndryshojnë drejtimin e lëvizjes së sendeve.  |                             |  | <b>Fjalë kyçe:</b> fërkim, kap, i lëmuar, i ashpër |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>Ngre hipoteza, bën parashikime dhe i shpalos ato.<br/>Mbledh prova dhe planifikon eksperimente, duke përdorur ndihmën.<br/>Kryen matje me anë të pajisjeve të thjeshta dhe i pasqyron vëzhgimet në disa mënyra.</p>   |   |  |
| <p><b>Burimet:</b> enciklopedi<br/><b>Mjete:</b> karrocë e vogël, forcëmatës, sipërfaqe të ndryshme</p>  | <p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b><br/>Shkencat (Fizikë), Matematikë</p> |  |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/>Leksion i përshpejtuar: Shpjegohet se fërkimi është një lloj force që vepron në momentin kur dy sipërfaqe bien në kontakt me njëra-tjetrën. Disa lloje materialesh shkaktojnë më tepër fërkim se të tjerat. Në këtë rast, ju duhet të përqendrohemi te fërkimi midis dy sendeve që lëvizin në varësi të njëra-tjetrës p.sh., kur zvarrisim një libër mbi sipërfaqen e tavolinës.<br/>Prova 1: Ju kërkohet nxënësve të fërkojnë duart me njëra-tjetrën. Përshkruajnë se çfarë ndiejnë.<br/>Prova 2: Nxënësit do të provojnë se si rrëshqet në sipërfaqe të ndryshme një karrocë lodër. Për të bërë parashikimin dhe përshkrimin e veprimtarisë e përfundimeve nxënësit do të përdorin fletën e punës 5.5 a. Përfundimet i diskutojnë në dyshe dhe më pas e gjithë klasa. Theksohet që nxënësit të tregojnë se ku vepron forca e fërkimit.<br/>Punë e pavarur: nxënësit plotësojnë individualisht fletët e punës 5.2 dhe 5.3. Më pas i këmbëjnë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin.</p> |   |  |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfshirjen dhe përdorimin e fjalëve të fjalorit shkencor në përputhje me temën. Për pjesëmarrjen në hetim dhe mendimet rreth përfundimeve.</p>  |   |  |
| <p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 35 Fletore Pune</p>   | <p><b>Refleksion:</b> Si duhet të jetë sheshi kur luajmë me patina?</p>   |  |
| <p><b>Shënim:</b> Për provën e dytë në fletën e punës 5.5 a përshkrimi bëhet me rrëshqitjen e tabakasë, mund të zhvillohet vëzhgimi me mjetet që keni në dispozicion.<br/>Në varësi të kohës, nxënësit mund të bëjnë disa vizatime ku të tregojnë raste në të cilën ndodh forca e fërkimit.</p>  |   |  |

## Ora 6

| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3                                 | Data |
|--|----------------------|---|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj  |                      | <b>Situata e të nxënësve:</b> Unë di... |      |
| <p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:<br/>Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br/>Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br/>Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.<br/>Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/>Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.<br/>Regjistron mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/>Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.<br/>Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.</p> |                      |   |      |
| <p>Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.<br/>Tregon kuriozitet për mënyrën e lëvizjes së trupave.<br/>Tregon kuriozitet për shkaqet e ndryshimit të lëvizjes së trupave kur mbi ta veprojnë forca.<br/>Vlerëson me objektivitet rezultatet e provave të tij krahasuar me ato të shokëve.</p>  |                      |   |      |

|   |  |
|---|--|
| Rezultatet e të nxënit sipas temës:<br>Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.<br>Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.   | <b>Fjalë kyçe:</b> i fortë, i butë, pa shkëlqim, me shkëlqim, magnet, tërheq, magnetik, jomagnetik |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjete:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra   | Lidhja me fushat e tjera: Shkencat (Fizikë) Art, Teknologji  |
| <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br>Duke përdorur fjalët e tabelës së fjalëve të reja të këtyre grup temash, nxënësit do të formojnë fjali në funksion të njohurive që kanë fituar.<br><i>Lojë kape topi:</i> Në grupe nxënësit formojnë një rreth. Nxënësi që ka topin thotë një fjalë dhe ai që e pret duhet të tregojë me një fjalë diçka që ka mësuar. Më pas nxënësi që ka topin, e hedh atë duke thënë një fjalë tjetër, kështu vazhdohet derisa përmenden të gjitha fjalët e tabelës.<br><i>Punë e pavarur:</i> Ftohen nxënësit të punojnë individualisht fq. 64-65 të librit.<br>Në fund diskutohen së bashku përfundimet e ushtrimit 1, 2 dhe 4. |  |
| <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për formulimin dhe përdorimin e duhur të fjalorit shkencor.   |  |
| <b>Detyra:</b> Punimi i fq. 36 Fletore Pune   | <b>Refleksion:</b> Keni ndonjë material tuajin të preferuar? Pse?                                  |
| <b>Shënim:</b> Një pjesë të kohës, nxënësit mund ta vënë në funksion të vazhdimet të përgatitjeve për projektin “krijojmë një lodër”.   |  |

## Ora 7

| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3  | Data |
|--|----------------------|--|------|
| <b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 3)  |                      | <b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...  |      |
| <b>Detyrë përmbledhëse/Test</b>  |                      |  |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br>Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.<br>Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br>Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.<br>Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br>Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.<br>Regjistron mënyrën e lëvizjes së trupave.<br>Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.<br>Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.<br>Krahason forcat që veprojnë mbi trupa. |                      |  |      |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.   |                      | <b>Fjalë kyçe:</b>   |      |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi<br><b>Mjete:</b> fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra   |                      | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Fizikë), Matematikë Art (Art pamor) |      |



|   |
|---|
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/>                 Nxënësit <i>prezantojnë</i> mbresat e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë.<br/> <i>Punë e pavarur:</i> Plotësimi i detyrave përmbledhëse.<br/>                 Diskutim dhe vetëvlerësim i punës së kryer.</p> |
| <p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për punimin e Detyrës përmbledhëse /Testit.</p>   |
| <p><b>Shënim:</b> Kjo orë mund të shfrytëzohet si testim ose si detyrë përmbledhëse e tremujorit të tretë.</p>  |

**Ora 8**

|   |                             |  |             |
|---|-----------------------------|--|-------------|
| <b>Fusha:</b> Shkencë   | <b>Lënda:</b> Dituri Natyre | <b>Klasa 3</b>   | <b>Data</b> |
| <b>Tema mësimore:</b> Projekt (ora 3) Krijojmë një lodër Panairi i krijimeve tona   |                             | <b>Situata e të nxënit:</b> Lodra jonë   |             |
| <p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b><br/>                 Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br/>                 Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br/>                 Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.<br/>                 Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.<br/>                 Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.<br/>                 Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br/>                 Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.<br/>                 Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/>                 Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.</p> |                             |  |             |
| <b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b><br>Krijon duke përdorur njohuritë e tij në lidhje me materialet dhe vetitë e tyre.   |                             | <b>Fjalë kyçe:</b> lodër, krijoj, ndërtoj, formoj, veti  |             |
| <b>Burimet:</b> enciklopedi   |                             | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Teknologji, Art,  |             |
| <b>Mjete:</b> materiale të ndryshme, fleta, lapsa, ngjyra   |                             | Qytetari   |             |
| <p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b><br/>                 Hapi 1: Secili grup diskuton mbi ecurinë dhe vështirësitë e projektit. Si mund të veprohet për t'i kaluar ato.<br/>                 Hapi 2: Organizimi i panairit.<br/>                 Hapi 3: Zhvillimi i panairit. Secili grup ka hapësirën e tij për të prezantuar lodrën e ndërtuar prej tyre. (Gjatë panairit nxënësit do të mundohen ta bëjnë sa më interesant prezantimin dhe të mundësojnë shitjen e lodrës së tyre.)</p>   |                             |  |             |
| <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për kreativiteti, bashkëpunimin, kontributin e tyre në realizimin e projektit të përbashkët.  |                             |  |             |
| <b>Detyra:</b>  |                             | <b>Refleksion:</b> Si u ndjetë? Për çfarë ndjeheni krenar? Çfarë do të donit të bënit më mirë? |             |
| <p><b>Shënim:</b> Kujdes në sqarimin e nxënësve se ata duhet të krijojnë një lodër të thjeshtë me të cilën mund të luhet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Theksohet se puna me lodrën do të jetë vetëm e nxënësve.</li> <li>- Projekti do të shtrihet në 2 orë mësimore të Diturisë së Natyrës dhe nëse është e nevojshme me orë të Kurrikulës me Zgjedhje (hapi 4 dhe 5).</li> <li>- Projekti mund të finalizohet dhe vetëm me prezantimin në panair, pa përfshirë në të shitjen e lodrës.</li> </ul>   |                             |  |             |

## **Tremujori i parë**

### **Njohuritë/konceptet**

#### **Bimët**

- Pjesët e një bime me lule.
- Kërkesat e një bime për të jetuar.
- Transporti i ujit te bima.

#### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:**

- Dallon se bimët kanë rrënjë, kërcell, gjethe dhe lule.
- Shpjegon nga vëzhgimet se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë që të rriten.
- Përshkruan si uji thithët nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit.
- Argumenton se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcel dhe gjethe, që të rriten mirë.
- Planifikon dhe kryen kërkime për të hetuar për çfarë kanë nevojë bimët.
- Eksploron rolin e lules në ciklin jetësor të një bime.

### **Njohuritë/konceptet**

#### **Njerëzit dhe kafshët**

- Të ushqyerit
- Mbështetja dhe lëvizja

#### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:**

- Tregon se disa ushqime mund të dëmtojnë shëndetin p.sh.: ushqimet shumë të ëmbla ose me shumë yndyrë.
- Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme për të ruajtur një shëndet të mirë.
- Tregon se kafshët, përfshirë njeriun, kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.
- Diskuton përmes shembujve se dieta e duhur dhe ushtrimet fizike janë të rëndësishme, për të ruajtur një shëndet të mirë.

## TEST

Emri \_\_\_\_\_


Data \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

### 1. Emërto pjesët e bimës.

Nëse dëshiron mund t'i ngjyrosësh.

4 (pikë)




**2. Emërto pjesët e bimës që kryejnë këtë funksion.**

3 (pikë)

| Funksioni  | Pjesa e bimës |
|--|---------------|
| Mbajnë bimën të fiksuar në tokë dhe ndihmojnë për të thithur ujin. |               |
| Mundëson transportimin e ujit.                                     |               |
| Prodhoet ushqimi.  |               |


**3. Trego me shigjetë rrugën që ndjek uji në bimë.**

1  
(pikë)



**4. Vendos numrat nga 1 deri në 4 për të treguar ciklin e jetës së bimëve.**

4 (pikë)



**5. Qarko përgjigjen e saktë:**

2 (pikë)

Pema është bimë.

Po Jo

Bima ujitet në gjethe.

Po Jo

**7. Plotëso:**

**6.  
3 (pikë)**

Një bimë e shëndetshme duhet të jetojë në temperaturë \_\_\_\_\_.

Një bimë e shëndetshme merr dritë nga \_\_\_\_\_.

Një bimë e shëndetshme thith nga toka \_\_\_\_\_.

**8. Trego si kujdesesh për shëndetin tënd:**

8 (pikë)

Ushqimet që ha janë \_\_\_\_\_

Lëngjet që pi janë \_\_\_\_\_

Ushtrimet fizike që bëj janë \_\_\_\_\_

Ja si pushoj \_\_\_\_\_

**9. Shkruaj dy këshilla për të mbajtur dhëmbë të shëndetshëm.**

2 (pikë)

---

---

---

| Vlerësimi | AP  | ANP   | AK    | ASHK   | ASH    |
|-----------|-----|-------|-------|--------|--------|
| Pikët     | 0-6 | 7- 14 | 15-17 | 18 -24 | 25- 27 |

**Suksese!**

## **Tremujori i dytë**

### **Njohuritë/konceptet**

#### **Njerëzit dhe kafshët**

- Të ushqyerit
- Mbështetja dhe lëvizja

#### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:**

- Tregon se kafshët përfshirë njeriun kanë nevojë të marrin sasinë dhe llojin e duhur të ushqimit që të jetojnë.
- Krahason dieta të kafshëve të ndryshme (përfshirë kafshët shtëpiake) dhe i grupon në bazë të ushqimit që ato hanë.
- Dallon se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë skelet dhe muskuj për mbështetje, mbrojtje dhe lëvizje.
- Ndan në grupe gjallesat në bazë të tipareve të thjeshta si: prania e skeletit dhe mënyra se si lëvizin.

# TEST

Emri \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

## 1. Shkruaj kujt i përkasin këto procese, gjallesave apo jogjallesave.

6 (pikë)

nuk lëvizin \_\_\_\_\_ marrin frymë \_\_\_\_\_  
kanë shqisa \_\_\_\_\_ nuk kanë nevojë për ujë e ushqim \_\_\_\_\_  
nuk rriten \_\_\_\_\_ riprodhohen \_\_\_\_\_

## 2. Qarko me ngjyrë të kuqe gjallesat dhe me ngjyrë blu jogjallesat.

8 (pikë)



## 3. Trego në tabelë me shenjën + cilit grup i përkasin kafshët: 5 (pikë)

| Kafshët         | Ka skelet rruazorë | Nuk ka skelet jorruazorë |
|-----------------|--------------------|--------------------------|
| macja           |                    |                          |
| pula            |                    |                          |
| krimbi          |                    |                          |
| kandili l detit |                    |                          |
| lopa            |                    |                          |

**4. Qarko përgjigjen e saktë:**

**4 (pikë)**

Delja është kafshë barngrënëse sepse ushqehet me bar.

Po Jo

Ariu është kafshë gjithçka ngrënëse.

Po Jo

Lepuri ushqehet me lakra ai është kafshë mishngrënëse.

Po Jo

Luani është kafshë mishngrënëse.

Po Jo

**5. Shkruaj tre emra kafshësh që kanë tipar të përbashkët, mënyrën si lëvizin.**

**3 (pikë)**

\_\_\_\_\_

**6. Jep një këshillë në lidhje me kujdesin për muskujt.**

**1 (pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**7. Trego dy tipare të ngjashme dhe dy tipare të ndryshme nga shoku ose shoqja juaj.**

**4 (pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

| Vlerësimi | AP  | ANP   | AK    | ASHK   | ASH    |
|-----------|-----|-------|-------|--------|--------|
| Pikët     | 0-7 | 8- 15 | 16-19 | 20 -27 | 28- 31 |

**Suksese!**



## Tremujori i tretë

### Njohuritë/konceptet

#### Lëndët

- Klasifikimi i materialeve
- Vetitë magnetike të materialeve
- Ndarja e materialeve

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

- Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.
- Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.
- Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.
- Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.
- Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.
- Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.
- Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.
- Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.
- Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.

#### Njohuritë/konceptet

##### Forcat

- Forca e shtytjes dhe tërheqjes
- Efektet e forcës në lëvizjen e trupave
- Fërkimi

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

- Përshkruan shtytjen dhe tërheqjen si shembuj të forcave.
- Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.
- Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.
- Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.
- Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.
- Regjistron mënyrën e lëvizjes së trupave.
- Regjistron forcat që veprojnë mbi trupat.
- Krahason mënyrën e lëvizjes së trupave.
- Krahason forcat që veprojnë mbi trupa.

# TEST

Emri \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

1. Shkruaj nga një veti për secilin prej materialeve:

3 ( pikë)

Qelq \_\_\_\_\_

Letër \_\_\_\_\_

Plastikë \_\_\_\_\_

2. Lidh materialin e përshtatshëm me objektin.

3 ( pikë)

qelq

dollap

dru

letër

libër

gotë

3. Qarko me ngjyrë të gjelbër objektet magnetike dhe me ngjyrë të verdhë objektet jomagnetike.

6 ( pikë)



4. Cila forcë është përdoret nëse:

6 (pikë)

tërheq makinën

shtyj derën

tërheq sirtarin

\_\_\_\_\_

mpreh lapsin

\_\_\_\_\_

shtyj shilarësin

\_\_\_\_\_

hap kapakun e shishes

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**5. Përmend emrat e dy lojërave me top, gjatë të cilave ndryshoni drejtimin e lëvizjes së tij.**

2 ( pikë)

---

---

**6. Trego dy raste ku nëpërmjet forcës mund të ndryshosh formën e materialeve.**

**2 ( pikë)**

---

---

---

**7. Qarko përgjigjen e saktë:**

**4 ( pikë)**

Forca matet me forcëmatës.

Po Jo

Forca e tërheqjes mundëson që këpucët të mos rrëshqasin.

Po Jo

Njësia matëse e forcës është njutoni (N).

Po Jo

Forca e shtytjes mundëson të lëvizim objektin drejt vetes.

Po Jo

**8. Përshkruaj objektin tënd të preferuar dhe trego materialin nga i cili ai është i përbërë.**

4 (pikë)

---

---

---

---

---

---

---

| Vlerësimi | AP  | ANP   | AK    | ASHK   | ASH    |
|-----------|-----|-------|-------|--------|--------|
| Pikët     | 0-7 | 8- 15 | 16-19 | 20 -27 | 28- 31 |

**Suksese!**

## PROJEKT

|  |                         |                    |                          |
|--|-------------------------|--------------------|--------------------------|
| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre    | Klasa 3            | Data                     |
| <b>Projekt: Krijojmë një lodër</b>   |                         |                    |                          |
| <p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:<br/>         Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br/>         Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br/>         Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.<br/>         Tregon kuriozitet për përdorimin e magneleve.<br/>         Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.<br/>         Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br/>         Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.<br/>         Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/>         Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.</p>   |                         |                    |                          |
| <b>ora</b>   | <b>Lënda</b>            | <b>Tematika</b>    | <b>Tema</b>              |
| Ora 1  | Dituri Natyre           | Materialet         | Krijojmë një lodër       |
| Ora 2  | Kurrikul me zg-         | Materialet         | Krijojmë një lodër       |
| Ora 3  | jedhje<br>Dituri Natyre | Forcat dhe lëvizja | Panairi i krijimeve tona |
| <p><b>Prezantim i projektit:</b> Qëllimi i këtij projekti është që ju (vetë nxënësit) të krijoni dhe ndërtoni një lodër me të cilën mund të luhet. Se sa e suksesshme do të jetë kjo lodër, do të duket nëse do të arrini ta prezantoni atë në “Panairin e lodrave”.</p> <p>Hapi 1: Në grupe do të diskutojnë rreth ideve në lidhje me lodrën interesante. Secili do t'i prezantojë grupit idenë e tij. Do të veçohet ideja më tërheqëse dhe e realizueshme nga vetë ata.</p> <p>Hapi 2: Analizë e pjesëve përbërëse dhe si do të funksionojnë ato. Përcaktimi i llojit të materialeve me të cilat do të punohet dhe kombinimi i vetive të tyre me funksionimin sa më të mirë. Që në këtë fazë mund të emërtohet lodra dhe krijohet një prezantim interesant për të (reklamë), si dhe një çmim shitje. Ky prezantim do të shërbejë për të tërhequr vëmendjen e pjesëmarrësve në panair.</p> <p>Hapi 3: Ndahen detyrat ndërmjet pjesëtarëve të grupit.</p> <p>Udhëzohen nxënësit se puna për ndërtimin e lodrës mund të vazhdojë dhe në shtëpi.</p> <p>Hapi 4: Secili grup diskuton mbi ecurinë dhe vështirësitë e projektit. Si mund të veprohet për t'i kaluar ato.</p> <p>Hapi 5: Organizimi i panairit dhe ftesa ndaj nxënësve të tjerë të shkollës.</p> <p>Hapi 6: Zhvillimi i panairit. Secili grup ka hapësirën e tij për të prezantuar lodrën e ndërtuar prej tyre.</p> |                         |                    |                          |
| <b>Refleksion:</b> Si u ndjetë? Për çfarë ndjeheni krenar? Çfarë do të donit të bënit më mirë?   |                         |                    |                          |
| <b>Shënim:</b> Nëse është e mundur, gjatë panairit nxënësit do të mundohen ta bëjnë sa më interesant prezantimin dhe të mundësojnë shitjen e lodrës së tyre.   |                         |                    |                          |

|  |                      |   |      |
|--|----------------------|---|------|
| Fusha: Shkencë   | Lënda: Dituri Natyre | Klasa 3   | Data |
| Tema mësimore: <b>Projekt (ora 1)</b><br>Krijojmë një lodër  |                      | Situata e të nxënët: Lodra jonë                     |      |
| <p>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:<br/>                     Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br/>                     Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br/>                     Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve sipas vetive të tyre.<br/>                     Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.<br/>                     Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.</p>   |                      |   |      |
| Rezultatet e të nxënët sipas temës:<br>Krijon duke përdorur njohuritë e tij në lidhje me materialet dhe vetitë e tyre.   |                      | Fjalë kyçe: lodër, krijoj, ndërtoj, formoj, veti    |      |
| Burimet: enciklopedi<br>Mjete: materiale të ndryshme, fleta, lapsa, ngjyra   |                      | Lidhja me fushat e tjera: Teknologji, Art, Qytetari |      |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br/>                     Diskutim: Cila është lodra juaj e preferuar? Pse? Nga se përbëhet ajo?<br/>                     Disa nga lodrat dhe materialet me të cilat është e ndërtuar ajo shkruhen në tabelë.<br/>                     Si mendoni ju pse është/janë zgjedhur pikërisht këto materiale për të ndërtuar këtë lodër?<br/>                     Nëse do të krijonit ju një lodër si duhet të ishte ajo? Me çfarë materiale mund të përdoshin?<br/>                     Prezantim i projektit: Qëllimi i këtij projekti është që ju (vetë nxënësit) të krijoni dhe ndërtoni një lodër me të cilën mund të luhet. Se sa e suksesshme do të jetë kjo lodër do të duket nëse do të arrini ta shisni atë në “Panairin e lodrave”.</p> <p>Hapi 1: Në grupe do të diskutojnë rreth ideve në lidhje me lodrën interesante. Secili do t’i prezantojë grupit idenë e tij. Do të veçohet ideja më tërheqëse dhe e realizueshme nga vetë ata.<br/>                     Hapi 2: Analizë e pjesëve përbërëse dhe si do të funksionojnë ato. Përcaktimi i llojit të materialeve me të cilat do të punohet dhe kombinimi i vetive të tyre me funksionimin sa më të mirë. Që në këtë fazë mund të emërtohet lodra dhe krijohet një prezantim interesant për të (reklamë) si dhe një çmim shitje. Ky prezantim do të shërbejë për të tërhequr vëmendjen e pjesëmarrësve në panair.</p> <p>Hapi 3: Ndahen detyrat ndërmjet pjesëtarëve të grupit.<br/>                     Udhëzohen nxënësit se puna për ndërtimin e lodrës mund të vazhdojë dhe në shtëpi.<br/>                     Hapi 4: Secili grup diskuton mbi ecurinë dhe vështirësitë e projektit. Si mund të veprohet për t’i kaluar ato.<br/>                     Hapi 5: Organizimi i panairit dhe ftesa ndaj nxënësve të tjerë të shkollës.<br/>                     Hapi 6: Zhvillimi i panairit. Secili grup ka hapësirën e tij për të prezantuar lodrën e ndërtuar prej tyre.</p> |                      |   |      |
| Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për kreativiteti, bashkëpunimin, kontributin e tyre në realizimin e projektit të përbashkët.  |                      |   |      |
| Detyra: Përgatitja sipas detyrave të caktuara në grup.   |                      | Refleksion:   |      |

Shënim: Kujdes në sqarimin e nxënësve se ata duhet të krijojnë një lodër të thjeshtë, me të cilën mund të luhet.

- Theksohet se puna me lodrën do të jetë vetëm e nxënësve.
- Projekti do të shtrihet në 2 orë mësimore të Diturisë së Natyrës dhe nëse është e nevojshme me orë të Kurrikulës me Zgjedhje (hapi 4 dhe 5).
- Projekti mund të finalizohet dhe vetëm me prezantimin në panair, pa përfshirë në të shitjen e lodrës.

|   |   |                                 |      |
|---|---|---------------------------------|------|
| Fusha: Shkencë  | Lënda: Dituri Natyre                                | Klasa 3                         | Data |
| Tema mësimore: <b>Projekt (ora 3) Krijojmë një lodër</b><br>Panairi i krijimeve tona  |   | Situata e të nxënit: Lodra jonë |      |
| <p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:<br/>                     Klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre.<br/>                     Tregon objektivitet kur kërkon informacion dhe të dhëna, që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e materialeve.<br/>                     Tregon kuriozitet për ndarjen e materialeve si pas vetive të tyre.<br/>                     Tregon kuriozitet për përdorimin e magnetëve.<br/>                     Eksploron dhe diskuton përdorimin e materialeve për qëllime të ndryshme.<br/>                     Përshkruan si forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre.<br/>                     Përshkruan si forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin; më shpejt; më ngadalë; t'i ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes.<br/>                     Demonstron lëvizjen e trupave si pasojë e tërheqjes dhe shtytjes.<br/>                     Hulumton ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.</p> |   |                                 |      |
| Rezultatet e të nxënit sipas temës:<br>Krijon duke përdorur njohuritë e tij në lidhje me materialet dhe vetitë e tyre.  | Fjalë kyçe: lodër, krijoj, ndërtoj, formoj, veti    |                                 |      |
| Burimet: enciklopedi<br>Mjete: materiale të ndryshme, fleta, lapsa, ngjyra  | Lidhja me fushat e tjera: Teknologji, Art, Qytetari |                                 |      |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br/>                     Hapi 4: Secili grup diskuton mbi ecurinë dhe vështirësitë e projektit. Si mund të veprohet për t'i kaluar ato.<br/>                     Hapi 5: Organizimi i panairit.<br/>                     Hap 6: Zhvillimi i panairit. Secili grup ka hapësirën e tij për të prezantuar lodrën e ndërtuar prej tyre. (Gjatë panairit nxënësit do të mundohen ta bëjnë sa më interesant prezantimin dhe të mundësojnë shitjen e lodrës së tyre.)</p>   |   |                                 |      |

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për kreativiteti, bashkëpunimin, kontributin e tyre në realizimin e projektit të përbashkët.

Detyra:

Refleksion: Si u ndjetë? Për çfarë ndjeheni krenar? Çfarë do të donit të bënit më mirë

Shënim: - Kujdes në sqarimin e nxënësve se ata duhet të krijojnë një lodër të thjeshtë me të cilën mund të luhet.

- Theksohet se puna me lodrën do të jetë vetëm e nxënësve.
- Projekti do të shtrihet në 2 orë mësimore të Diturisë së Natyrës dhe nëse është e nevojshme me orë të Kurrikulës me Zgjedhje (hapi 4 dhe 5).
- Projekti mund të finalizohet dhe vetëm me prezantimin në panair, pa përfshirë në të shitjen e lodrës.